


# RELACION TEKNIK

## **NDERTIMI I GODINES SE BASHKISE DIVJAKE**



PROJEKT ZBATIMI :

***“NDERTIMI I GODINES SE BASHKISE DIVJAKE”***

INVESTITORI:

***FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT***

VENDNDODHJA:

***QYTETI DIVJAKË, BASHKIA DIVJAKË***

PROJEKTUES:

***CEC GROUP sh.p.k***

***Tirane 2020***

- **Te përgjithshme**

Territori i Bashkisë zë afërsisht **1 %** të sipërfaqes së gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë. Bashkia e Divjakes në veri kufizohet me lumin Shkumbin, në lindje me Bashkinë Lushnje dhe autostradën SH 4, në jug me Bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik. Në përgjithësi relievi i Bashkisë Divjakë është fushor dhe pak kodrinor. Bashkia e Divjakës ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike.

Territori i Bashkisë Divjakë gjendet në pjesën Perendimore të Shqipërisë. Bashkia shtrihet në drejtimin veri-jug me gjatësi maksimale të vijës bregdetare prej rreth 30 km dhe lindje-perëndim me një gjatësi maksimale prej 20 km. Me ndarjen e re Territoriale Administrative, Bashkia është bashkuar edhe njësi Administrative Remas. Me popullsi prej 54 000 banorë dhe me decentralizimin e funksioneve drejt bashkive dhe dixhitalizimin e shumë shërbimeve, administrata e Bashkisë Divjakë gjendet në vështirësi dhe në kushte të pamundura për të dhënë shërbim qytetarëve dhe kryer detyrimet ligjore.

- Gjendja aktuale e Ndertimit

Aktualisht godina ekzistuese e Bashkisë nuk arrin të permbush hapësirën e nevojshme për kryerjen e të gjitha funksioneve administrative të Bashkisë. Për këtë, deri më sot Bashkia ka përfshirë sipërfaqen e ish-Qendres Shëndetësore dhe sipërfaqe të tjera të bashkengjitura saj. Gjithashtu, Bashkia ka marrë dhe ambjente të tjera me qira të cilat përbejnë kosto të vazhdueshme në buxhetin e Bashkise. Mos funksionimi në afërimitet, pra mungesa e nje objekti fizik të përqendruar për të gjitha drejtoritë dhe sektorët e Bashkise, përbën vështirësi fizike dhe kosto ekonomike. Eshtë e planifikuar që të prishen 2 godinat ekzistuese. Ish qendra shëndetësore me sipërfaqe 608 m<sup>2</sup>te ndertuara me struktura tulle me themel beton arme dhe 2 soleta betoni do të prishet , godina ekzistuese me tulla te plota mbajttese cati druri e mbuluar me tjegulla dhe tavan res kallemi me sipërfaqe 624 m<sup>2</sup> aktualisht e perdorur si godine bashkies dhe objekti egzistues 1 kt i ndertuar me tulla te plota mbajtejtese me solete me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup> do të prishen për të lëruar sheshin e ndertimit të godines se re të bashkise. Në këto objekte nuk ka infrastrukturë ekzistuese të KUB, KUZ apo linja të tensionit të mesëm e të lartë. Të gjitha këto lidhje behen në lagjet që kufizojnë me godinat ekzistuese.



Fig.1 Ambientet egzsistuese te perdorura per administraten e Bashkise Divjake.

**Organigrama e administrates se Bashkise Divjake:**

| <b>Nr.</b>  | <b>EMËRTIMI</b>                                                                       | <b>Numri i punonjësve</b> |
|-------------|---------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------|
| <b>1.</b>   | <b>KRYETAR</b>                                                                        | <b>1</b>                  |
| <b>2.</b>   | <b>N/KRYETAR</b>                                                                      | <b>2</b>                  |
| <b>3.</b>   | <b>SEKRETAR I KRYETARIT</b>                                                           | <b>1</b>                  |
| <b>4.</b>   | <b>SEKRETAR I KESHILLIT BASHKIAK</b>                                                  | <b>1</b>                  |
| <b>5.</b>   | <b>ZEDHENES PER SHYP</b>                                                              | <b>1</b>                  |
| <b>II</b>   | <b>AUDITI I BRENDSHËM</b>                                                             | <b>3</b>                  |
| <b>III</b>  | <b>SEKTORI JURIDIK DHE PROKURIMEVE PUBLIKE</b>                                        | <b>5</b>                  |
| <b>IV</b>   | <b>DREJTORIA FINANCËS, BUXHETIT DHE BURIMEVE NJERËZORE</b>                            | <b>17</b>                 |
| <b>(B)</b>  | <b>SEKTORI BURIMEVE NJERËZORE, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE PROTOKOLL/ARKIVA</b> | <b>6</b>                  |
| <b>V</b>    | <b>SEKTORI MIRËQENIES SOCIALE DHE PËRKUJDESIT SHOQËROR</b>                            | <b>7</b>                  |
| <b>VI</b>   | <b>DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT</b>                        | <b>7</b>                  |
| <b>VII</b>  | <b>DREJTORIA TAKSAVE DHE TË ARDHURAVE VENDORE</b>                                     | <b>3</b>                  |
| <b>VIII</b> | <b>DREJTORIA BUJQËSISË, MJEDISIT DHE UJITJES</b>                                      | <b>44</b>                 |
| <b>(A)</b>  | <b>SEKTORI I MJEDISIT DHE PYJEVE</b>                                                  | <b>7</b>                  |
| <b>IX</b>   | <b>SEKTORI MENAXHIMIT DHE MBROJTJES TOKES</b>                                         | <b>8</b>                  |
| <b>X</b>    | <b>INSPEKTORIATI VENDOR MBROJTJES SË TERRITORIT</b>                                   | <b>3</b>                  |
| <b>XI</b>   | <b>INSPEKTORIATI MBROJTJES CIVILE</b>                                                 | <b>8</b>                  |
| <b>XII</b>  | <b>DREJTORIA KULTURËS, SPORTIT DHE ARSIMIT</b>                                        | <b>2</b>                  |
| <b>XIII</b> | <b>SEKTORI I RRUGËVE RURALE (FUNKSION I DELEGUAR)</b>                                 | <b>25</b>                 |
| <b>VX</b>   | <b>SEKTORI I PRITJES DHE INFORMIMIT TE PUBLIKUT</b>                                   | <b>2</b>                  |
| <b>XV</b>   | <b>NENPUNES GJENDJES CIVILE</b>                                                       | <b>1</b>                  |
| <b>XVII</b> | <b>SEKTORI SHËRBIMEVE TURISTIKE</b>                                                   | <b>4</b>                  |
|             | <b>TOTALI</b>                                                                         | <b>141</b>                |

*Fig.2 Fotografi te godinave egzistuese te Bashkise Divjake.*





Foto te gjendjes egzistuese LINDJA



Foto te gjendjes egzistuese LINDJA





Foto te gjendjes egzistuese LINDJA



Foto te gjendjes egzistuese JUGU



Foto te gjendjes egzistuese PERENDIMI



Foto te gjendjes egzistuese VERIU (fasada nga sheshi qendror)





Foto te gjendjes egzistuese VERI-JUGU

Godina e re e bashkise do te ndertohet ne token shtet midis rrugeve Rruga Italia ne veri , Rruga Vikthi ne jug dhe Perendim dhe rruga e re qe do te ndertohet si segment i rruges Italia ne Lindje.

Koncepti për godinën e re përbëhet nga dy trupa që nderveprojnë me njeri tjetrin duke shfaqur formën katrore me dimensione te jashtme 45m me drejtimin Lindje –Perendim dhe 34.1 m në drejtimin Veri-Jug.

Godina e re është organizuar në 3 kate dhe me një kat nëntokë.

**Kati Nëntoke** ka një sipërfaqe ~**1364.00 m<sup>2</sup>**. Në të janë përfshire funksionet si parkim për administratën dhe publike.

**Ne Katin Perdhe** janë organizuar shërbimet onestopshop, kontakti dhe pritja e qytetareve .

Kati përdhe ka nje sipërfaqe ~ **624.07 m<sup>2</sup>**.

**Kati i Pare** me nje sipërfaqe~**1173.65 m<sup>2</sup>** janë në funksion të Administrates dhe Keshillit të Bashkisë, me zyra dhe ambjentet përkatëse.

**Kati i Dyte** me një sipërfaqe ~ **1146.04 m<sup>2</sup>** janë në funksion të Administrates

Ndërthurja e dy trupave krijon në qendër një atrium, pra një hapësirë të lirë të përbashkët qëndrore me dimensione 27.5 m me 21.1 m dhe sipërfaqe 577.5 m<sup>2</sup>do të përdoret si hapësirë që do të shfrytëzohet për administratën dhe banorët në raste organizimi eventesh .

Hyrja për në objekt do të realizohet nëpërmjet një rampe përnë kati nëntoke dhe 3 nyje shkalle ashensor për katin e parë dhe të dytë të administratës. Shkallët janë të vendosura me distanca që respektojnë kushtet e evakuimit në raste zjarri dhe do të shërbejnë edhe si shkalle emergjence. Godina do të jetë e aksesueshme me rrugë shërbimi në të gjitha anët. Rruga kryesore në anën veriore përballë sheshit qendror dhe rruge shërbimi përgjatë anës lindor që lidhet me rrugën ekzistuese në anën jugor, gjithashtu lidhet edhe me rrugën ekzistuese në anën perendimor ku janë të organizuar parkimi i hapur bashkë me lulishten dhe hapësirat e lira për banorët. Planifikohet ndertimi i vetem nje segmenti rrugor me gjatesi 100 ml ne krahun lindor te objektit.

Objekti i konceptuar në formëkatrore, në katin perdhe transparent dhe dy katet e tjera te trajtuara me fasade të ajrosur pjeserisht dhe pjeserisht me material terrakote krijojne nga pikpamja arkitektonike objektin simbol per te gjithë qytetin. Ndarjet e ambienteve të brendshme do të realizohen me mure kartoxhesi të izoluar me fiber xhami ndërsa ana nga korridori ku janë

pozicionuar zyrat do të jenë me fasade xhami për të krijuar transparence dhe komunikim viziv të zyrave me pjesën e jashtme të objektit. Tavanet do të realizohen me kartonxhes ku në të do të kalojnë impiantet elektrike të ndriçimit dhe kondicionimi. Fasada e zyrave është e gjitha me xham dhe hijezimi do të realizohet nëpërmjet panelave të aluminit model 'brisolei'.

Objekti nuk do të shërbejë vetëm si godinë në funksion të shërbimeve por dhe si njëvlerë e shtuar për peisazhin e sheshit qendror dhe të qytetit në tërësi. Përdorimi i sistemeve inovative siç janë fasada e venteluar, mireizolimi termik dhe hidrik, sistemi qendror i kondicionimit i të gjithë objektit do të ndihmojë jo vetëm në rritjen e efikasitetit energjetic por do sjellin kursime të konsiderueshme në buxhin e bashkisë dhe mirëmbajtjen ndër vite.





Fig 3. Planvedosja e strukture

Në katin përfaqësues të gjithë hapësira e lirë do të shërbejë jo vetëm për objektin por si pjesë e integruar e sheshit qendror që do të shërbejë edhe për qytetin dhe si qendër e bllokut të banimit të sotit.

Në të janë planifikuar vendparkim për 16 mjete, hapësira të gjelbra dhe ambiente shlodhese.


Jug



*Fig. 4 Planivolumetria e objektit*

Sipërfaqja e katit nëntokështë **1364.00 m<sup>2</sup>** me 37 vende parkimi. Në të janë pozicionuar dhe aksesit për personat me aftësi të kufizuar qëshërbehet nga 1 rampe dhe dy shkallët në fasadën veriore. Gjithashtu në anën jug-lindor do të jetë një magazinë dhe ambjenti teknik ku do të sisemohen matesit dhe komandimi i sistemeve të objektit.

Lartësia e katit është 3.2 m dysheme tavan. I gjithë kati do të jetë i pajisur me të gjitha sistemet si ndricim , alarm zjarri , sinjalistike, dhe sensor levizje etj.








### 3. Kati perdhe

Kati përdhe është organizuar si hapësirë për takime me publikun, marrje dhe dhënie e informacionit nëpërmjet shërbimeve që kanë lidhje me qytetarët. Hapësirat janë të rrethuara me fasade xhami në mënyrë që të lejojnë transparence me katin përdhe dhe për të krijuar vazhdimësinë e sheshit qendror.

Hyrja kryesore e godinës është në Verior ku do të mund të aksesohet nëpërmjet dy grupeve të shkallës dhe ashensorëve. Shkallët në Veri Lindje komunikojnë deri në katin e parë të zyrave ku dhe do të përdoren nga kryetari. Grupi i shkallës dhe ashensorit në Veri-Perëndim do të përdoret nga Këshilli Bashkiak për në katin e parë dhe zyrat e administratës në anën perëndimor të godinës dhe me katin e dytë të zyrave.

Në katin përdhe me sipërfaqe **624.07 m<sup>2</sup>** janë të organizuara :

3 nyjet e lëvizjes vertikale për në objekt, 2 nyje higjieno sanitare, Zyra e one-stop shopit, ambiente pritje dhe ekspozitive në hollin e hyrjes kryesore, kujdesi ndaj klientit OSHEE, një ambient bar kafe dhe shërbime për administratën.






#### 4. Kati i parë

Në katin e parë janë të organizura sipas anevë 3 nje shkalle/ashensor sëbashku me nyjet higjenosanitare që shërbejnë të gjithë godinën. Në fasadën Veriore janë pozicionuar ambientet e kryetarit , salla e këshillit bashkiak dhe 2 ambiente për sekretaret e keshillit, kryetarit të bashkisë sëbashku me ambientin e sekretarisë. Në anën perëndimor janë të pozicionuara shërbimi social dhe burimet njerëzore sëbashku me arkiven ne këndin jug-perendimor. Nëanën jugor janë të pozicinouara ambientet e zyrove juridike dhe zyrat arsimore. Ne anën lindor zyrat e financës.

Kati i parë ka nje siperfaqe **1173.65 m<sup>2</sup>** dhe ka 2 nje higjenosanitare për administratën dhe këshillin bashkiak dhe 1 nje për ambientet e kryetarit .


Objekti është projektuar për të mos pasur qarkullim në katin e parë për administratën. Lidhja e së cilës do të realizohet vetëm në katin e dytë administativ.





## 5. Kati i dyte

Kati i dytë administrative ka nje siperfaqe **1146.04 m<sup>2</sup>**dhe është i shërbyer nga 2 korpuse shkalle dhe ashensore, dhe i gjithë objekti është i lidhur me korridor perimetral. Janë të organizuara nëanën verior zyrat e kadastres dhe urbanistikës, nëanën lindor ndërmarja komunale , sh.a ujësjellësi , në anën jugor janë te organizuara zyra mjedisit dhe nënkryetari. Ne anën perëndimor në këtë kat, pra Kati i dytë, ka dy nje higjenosanitare ngjitur me grupin e shkalleve





## 6. Tabela me të dhënat e përgjithshme dhe sipërfaqe për cdo kat

| Nr. KATIT                       | FUNKSIONET             | SIPERFAQJA (m <sup>2</sup> ) |
|---------------------------------|------------------------|------------------------------|
| Kati Nentoke                    | Magazine               | 34.71                        |
| Kati Nentoke                    | Parkim                 | 1269.20                      |
| Kati Nentoke - Siperfaqja Total |                        | 1303.90                      |
| Kati Perdhe                     | One stop shop          | 80.01                        |
| Kati Perdhe                     | NHS                    | 9.26                         |
| Kati Perdhe                     | NHS                    | 5.45                         |
| Kati Perdhe                     | Holli                  | 154.67                       |
| Kati Perdhe                     | Bar, Kafe              | 78.76                        |
| Kati Perdhe                     | NHS                    | 4.93                         |
| Kati Perdhe                     | Kendi BE / Zyrat OSHEE | 96.53                        |
| Kati Perdhe                     | NHS                    | 9.01                         |
| Kati Perdhe                     | Korridor               | 28.19                        |
| Kati Perdhe                     | NHS                    | 5.80                         |
| Kati Perdhe                     | NHS                    | 5.24                         |
| Kati Perdhe                     | Korridor               | 22.31                        |
| Kati Perdhe                     | Korridor               | 8.56                         |
| Kati Perdhe – Siperfaqja Totale |                        | 530.45                       |
| Kati i Pare                     | Sherbimi social        | 17.40                        |
| Kati i Pare                     | NHS                    | 4.67                         |
| Kati i Pare                     | NHS                    | 4.40                         |
| Kati i Pare                     | Sekretar Keshilli      | 17.85                        |
| Kati i Pare                     | Sekretari              | 20.37                        |
| Kati i Pare                     | Sekretar Keshilli      | 17.30                        |
| Kati i Pare                     | Burimet njerezore      | 17.59                        |
| Kati i Pare                     | Burimet njerezore      | 17.26                        |
| Kati i Pare                     | NHS                    | 9.04                         |
| Kati i Pare                     | NHS                    | 2.65                         |
| Kati i Pare                     | NHS                    | 2.63                         |
| Kati i Pare                     | NHS                    | 6.80                         |
| Kati i Pare                     | Financa                | 46.84                        |
| Kati i Pare                     | NHS                    | 4.34                         |
| Kati i Pare                     | NHS                    | 9.23                         |
| Kati i Pare                     | Zyra arsimore          | 17.47                        |
| Kati i Pare                     | Zyra arsimore          | 17.33                        |
| Kati i Pare                     | Zyra juridike          | 17.33                        |
| Kati i Pare                     | Zyra juridike          | 17.17                        |
| Kati i Pare                     | Zyra juridike          | 17.80                        |
| Kati i Pare                     | NHS                    | 4.96                         |
| Kati i Pare                     | Arkiva                 | 67.47                        |
| Kati i Pare                     | Sherbimi social        | 16.24                        |
| Kati i Pare                     | Salla e keshillit      | 94.92                        |
| Kati i Pare                     | Zyra e Kryetarit       | 48.27                        |
| Kati i Pare                     | Korridor               | 54.68                        |
| Kati i Pare                     | Financa                | 34.52                        |
| Kati i Pare                     | Financa                | 17.21                        |
| Kati i Pare                     | Financa                | 15.78                        |
| Kati i Pare                     | Korridor               | 129.11                       |
| Kati i Pare                     | Zyre Arsimore          | 18.22                        |





|                                              |                                   |                |
|----------------------------------------------|-----------------------------------|----------------|
| Kati i Pare                                  | Burime njerezore                  | 16.10          |
| Kati i Pare                                  | Sherbim social                    | 17.32          |
| Kati i Pare                                  | Korridor                          | 115.17         |
| <b>Kati i Pare - Siperfaqja Totale</b>       |                                   | <b>935.42</b>  |
| Kati i Dyte                                  | NHS                               | 10.02          |
| Kati i Dyte                                  | N/ Komunale                       | 17.18          |
| Kati i Dyte                                  | NHS                               | 5.22           |
| Kati i Dyte                                  | Urbanistika                       | 16.68          |
| Kati i Dyte                                  | Urbanistika                       | 17.46          |
| Kati i Dyte                                  | Urbanistika                       | 34.34          |
| Kati i Dyte                                  | Zyre Kadastra                     | 17.74          |
| Kati i Dyte                                  | Zyre Kadastra                     | 17.77          |
| Kati i Dyte                                  | Zyre Kadastra                     | 17.25          |
| Kati i Dyte                                  | Zyre Kadastra                     | 31.02          |
| Kati i Dyte                                  | NHS                               | 5.18           |
| Kati i Dyte                                  | NHS                               | 12.20          |
| Kati i Dyte                                  | NHS                               | 5.54           |
| Kati i Dyte                                  | NHS                               | 4.41           |
| Kati i Dyte                                  | Zyre Arkiva                       | 34.19          |
| Kati i Dyte                                  | N/ Komunale                       | 16.58          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra Ujesjellesi                  | 17.51          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra Ujesjellesi                  | 16.39          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra Mjedisi                      | 17.44          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra Mjedisi                      | 17.22          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra Mjedisi                      | 17.55          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra e Sekretarit te Pergjithshem | 17.93          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra e Nenkryetar                 | 18.53          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra e Nenkryetar                 | 18.53          |
| Kati i Dyte                                  | NHS                               | 4.60           |
| Kati i Dyte                                  | NHS                               | 4.03           |
| Kati i Dyte                                  | Zyra Ujesjellesi                  | 16.33          |
| Kati i Dyte                                  | N / Komunale                      | 17.06          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra Mjedisi                      | 15.66          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra Mjedisi                      | 17.58          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra Mjedisi                      | 17.63          |
| Kati i Dyte                                  | Dhoma Sanitare                    | 17.63          |
| Kati i Dyte                                  | Dhoma Sanitare                    | 17.29          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra Mjedisi                      | 16.63          |
| Kati i Dyte                                  | Zyra Urbanistika                  | 17.91          |
| Kati i Dyte                                  | Korridor                          | 209.70         |
| Kati i Dyte                                  | Korridor                          | 140.47         |
| Kati i Dyte                                  | NHS                               | 8.33           |
| <b>Kati i Dyte - Siperfaqja Total</b>        |                                   | <b>924.09</b>  |
| <b>SIPERFAQJA E HAPESIRAVE NETO TE PUNES</b> |                                   | <b>3693.87</b> |



## 7. Teknologjia e ndërtimit.


Nga ana teknologjike është kushtuar vëmendje e vecantë për hidro dhe termoizolimin e objektit . Muri perimetral do të realizohet me tullë bllok 25 cm dhe termoizolimi do të realizohet me fasaden e ajrosur që do të realizohet në terrakote me panele fiber xhami.



*Shembull ilustrativ*




Ndërsa fasada e brendshme do të realizohet me xham struktural termik e hijezuar me elementin e brisolei alumini vertikal.



*Shembull ilustrativ*

Muret e brendshme do të realizohen me kartonxhes dhe panele fiber xhami për izolimin akustik.



Shenim : Muret do te ndertohen me kartonxhes te fiksuar ne strukture alumini.  
Shenim : Mbushja e mureve do te realizohet me panele fibra xhami 8 cm



8. Informacion për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujrave të ndotura si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit.




Fig. 1 Plani i lidhjes se objektit me infrastrukturen

Te gjitha sistemet e impianteve do te jene te organizuara. Impiantet elektrike dhe sistemet e ndryshme teknologjike siç janë sistemi i alarm it kundër zjarrit dhe i kamerave do te organizohen në të gjitha ambientet e objektit. .

Për sa i përket ujërave bardha dhe te zeza do te grumbullohen sipas kushteve higjeno-sanitare dhe projektit te prezantuar ne projektin e zbatimit.

Kullimi i ujërave te shiut do te organizohet për t'u shkarkuar ne kanalet e kullimit jashtë territorit te zhvillimit te objektit. Lidhja me ujin e pijshëm do te realizohet me rrjetin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime, Divjake.



Furnizimi me ujë do të bëhet me ujin e rrjetit të ujësjellësit që furnizon zonën Qytetit të Divjakes.

Projekti i instalimeve hidro-sanitare, është bazuar në projektin arkitektonik dhe atë konstruktiv të paraqitur nga investitori i objektit.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme dhe kërkesave të investitorit është realizuar projekti i objektit të mësipërm. Furnizimi me ujë brenda ndërtesës do të bëhet nga rrjeti shpërndarës i Ujësjellësit Divjake dhe me anë të kolonës kryesore të shpërndarjes do të shpërndahet tek njejtë sanitare *te çdo kati*. Tubacioni i ujit të kolonave deri tek kolektorët e njejtëve sanitare do të jetë polipropileni **PP-r** të termoizoluar

Llogaritjet e sistemit të furnizimit me ujë bëhen në bazë njëkohshmërisë së përdorimit të pajisjeve sanitare. Kështu metoda e përdorur është ajo e shumës së ekuivalenteve të gjithë aparateve sanitare si më poshtë:

| Tipi i aparatit | Prurja                    |
|-----------------|---------------------------|
| • Wc –          | 1.5 l/s; ( me flusometer) |
| • Bi –          | 0.1 l/s;                  |
| • Lv –          | 0.1 l/s;                  |
| • Du –          | 0.15 l/s;                 |
| • Vb –          | 0.2 l/s;                  |
| • Lt –          | 0.1 l/s;                  |
| • Lp –          | 0.2 l/s;                  |
| • Lst –         | 0.2 l/s;                  |

*b. Shkarkimi i ujërave të ndotura*

Shkarkimi i ujërave të ndotura do të bëhet në rrjetin e kanaliximeve të ujërave të ndotura të Bashkisë Divjake ashtu si është shpjeguar më poshtë. Sistemi i shkarkimeve është realizuar i bazuar në projektin arkitektonik dhe atë konstruktiv të paraqitur nga arkitekti.

Kollonat vertikale të shkarkimit janë në këto rast janë zgjedhur prej PP me gomina kundër zhurmës dhe janë në të dyja rastet të shoqëruara me tubacion ventilimi për vet kollonën me dimension jo më të vogël se 2/3 e dimensionit të kollonës së shkarkimit. Kollonat vertikale janë të kompletuara në çdo kat me rakorderi për mbrojtje nga ndryshimet termike.

Kolektorët e brendshëm horizontal shoqërohen me rakorderi për mbrojtje nga ndryshimet termike dhe për pastrimin e tyre. Mbledhja e linjave sekondare është bërë në tavanin e katit poshtë për të bërë të mundur kontrollin dhe riparimin e tyre sa më shpejt.

Linjat e horizontale dhe ato vertikale janë të kapura me fasheta sipas diametrave përkatës dhe largësive të mëposhtme: Në dalje të objektit kolektorët horizontal shoqërohen me sifon të pastrueshëm në një pusëtë të vogël ngjitur me objektin, dhe që aty shkojnë në rrjetin e kanalizimit të objektit që nuk bashkohet deri në kolektorin e rruges me ujrat e shiut.

Të gjitha kollonat e vertikale të shkarkimit, kolektorët horizontal brendshëm dhe të jashtëm llogariten në baze të prurjeve llogaritese të aparateve sanitare të një tipi, numri i tyre si dhe njëkohshmëria e përdorimit të tyre. Të gjitha ujrat e ndotura do të mbidhen në 2 pusëta 80 x 80 \* 150 cm lidhen me sistemin e kanalizimeve të KUZ rajoni I sotallareve.

Prurja e llogaritur merret në baze të tipit të përdoruesve që në rastin tonë është llogaritur me formulën e mëposhtme:

$$G_{pr} = F \cdot (G_t)^{0,5}$$

*Ku kemi:*

*G<sub>pr</sub> – prurja llogaritese*

*G<sub>t</sub> – prurja totale e aparateve sanitare*

*F – faktori i njëkohshmërisë që për rastin tonë merret 0,7*

Ku prurjet e të gjithë aparateve sanitare janë shprehur si më poshtë:

| Tipi i aparatit | Prurja   |
|-----------------|----------|
| • Wc –          | 2.5 l/s; |
| • Bi –          | 0.5 l/s; |
| • Lv –          | 0.5 l/s; |
| • Du –          | 0.5 l/s; |
| • Vb –          | 1.0 l/s; |
| • Lt –          | 1.2 l/s; |
| • Lp –          | 0.1 l/s; |
| • Lst –         | 1.0 l/s; |
| • Pdy-          | 1.0 l/s  |

Permbledhurazi instalimet elektrike përfshijnë: Pikelidhja, kabllimi TM, Kabina Elektrike e transformatorit, matja e energjisë elektrike, stabilizimi i tensionit, rifazimi, sistemi motor-gjenerator, UPS, panelet elektrike të shpërndarjes, blindoza, kabllot shpërndarës, si dhe trasetë e kalimit të tyre.

#### **Instalime elektrike, shpërndarja e energjisë elektrike.**

Automatet termo-magnetike tre fazorë TU janë parashikuar që të kenë kapacitetin të përballojnë, përcjellin dhe ndërpresin rrymat në kushte normale dhe gjithashtu të përballojnë, përcjellin rrymat për një kohë të caktuar si dhe të ndërpresin rrymat në kushte jo normale për një qark, si dhe atë të lidhjes së shkurtër.

Janë parashikuar paisje ndërtimi i të cilave përmbush kërkesat e më poshtme:

- Qëndrushmeri ndaj kushteve të tensionit dherrymës.
- Qëndrushmeri të përshtatëshme për kushtet e mjedisit

Automatët Termo-Magnetik TU, përgjithësisht, do të mund të përdoren /komandohen në mënyrë manuale. Disa njeje si "ATS" etj komandohen automatikisht.

Automatet do të montohen në panele. Panelet, prodhim standard, të kompletuar me dyer, grila ventilimi, bazamente, zbara, kanalina përcjellsish etj.

Në çdo kat është parashikuar dhomë teknologjike për montimin e paneleve. Dyert e dhomave do të jenë të mbyllura me çelës.

#### *d. Siguria nga zjarri në godina industriale*

Ashtu si ne çdo objekt, menaxhimi i kabanonit, duhet të njohe se **standardet e sigurisë** duhet të reflektojnë një kulturë të sigurisë në godina. Siguria nga zjarri ne godina industriale është një konsideratë e rëndësishme për projektimin dhe ndërtimin e tyre..

#### **Siguria nga zjarri në godina**

**OBJEKTI** do të sistemohet e do të shtrohet me rrugë e drenazhime për kullimin e ujrave, me shkallë, me dalje emergjence, ku do të vendosen. Hidrante zjarri të jashtëm. I gjithë sheshi ku do të ndërtohet godina është sistemuar sipas rregullave të urbanistikës dhe shërbimit zjarrfikës. Godina në përberje do të përshkohet rreth e rrotull saj me rrugica të cilat bëjnë të mundur manovrimin e lirshëm të makinave zjarrfikëse dhe atyre teurgjence.

Hyrja për në godina do të bëhet nëpërmjet hyrjes nga pas të objektit e cila është 3□4m e gjere.

Në vendosje dhe në largësi midis objekteve të tjera nuk ka shkelje të normave të mbrojtjes nga zjarri.

## 9. Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit

Për zhvillimin e projektit duhet kaluar në disa faza:

- Si fillim u përcaktua toka në të cilën do të zhvillohet ndërtimi e cila është tokë në pronësi të Bashkisë Divjake
- Piketimi i ndërtesës në kuota absolute
- Rilevimi i sipërfaqes
- Porojekt ideja për objektin e kërkuar nga investitori.
- Zbatimi i projektit të aprovuar pasi të jenë marrë të gjitha lejet

Produkti përfundimtar do të jetë ndërtimi i projektit: “Ndërtimi I godines së Bashkisë Divjake”

Kohëzgjatja e planifikuar për funksionimin e projektit

Objekti do të funksionojë deri në kohën dhe afatin e amortizimit për objektet me funksion shërbimi. Gjatë kësaj periudhe do të ketë ndërhyrje të herë pas herë për mirëmbajtje.

Objekti do të sistemohet e do të shtrohet me rrugë e drenazhime për kullimin e ujërave ,me shkallë , me dalje emergjence , ku do të vendosen. Hidrantë zjarri të jashtëm. I gjithë sheshi ku do të ndërtohet godina është sistemuar sipas rregullave të urbanistikës dhe shërbimit zjarrfikës. Godina në përbërje do të përshkohet rreth e rrotull saj me rrugica të cilat bëjnë të mundur manovrimin e lirshëm të makinave zjarrfikëse dhe atyre të urgjencës.

Në vendosje dhe në largësitë midis objekteve të tjera nuk ka shkelje të normave të mbrojtjes nga zjarri.



## 10. Mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit

Objekti do të ndërtohet me teknologji tradicionale. Kjo skemë do të garantojë një efikasitet energjitik optimal për të gjithë objektin duke ulur kostot e shpenzimeve në energji të objektit. Muraturat do të ndërohen me tullë me vrima të suvatuar në pjesën e jashtme do të përdoret grafiato

### **Punime dheu**

#### *Përgatitja e formacioneve*

Përgatitja e formacioneve përfshin këto punë:

- Njohja dhe saktësimi i rrjeteve të instalimeve në tokë si p.sh.: tuba të furnizimit të ujësjellësit, tuba të shkarkimit, kablllo elektrike e telefonie etj
- Matja e terrenit dhe marrja e provave të dheut
- Shpyllëzimi dhe heqja e rrënjëve prej terrenit
- Heqja e dheut me humus dhe transportimi apo ripërdorimi i saj
- Hapja e gropave të themeleve deri në thellësinë e nevojshme

#### *Përpunimi i pjerrësive*

Në rastet e terrenit me pjerrësi veprohet sipas tre mënyrave të mëposhtme:

- Nivelimi i pjerrësisë sipas pikës më të ulët të terrenit
- Mbushja e terrenit me material ekstra, deri në nivelin e pikës më të lartë të terrenit
- Gërmime dhe mbushje sipas pikës mesatare

Secila nga këto raste do të përdoret në varësi të llojit të dheut, të aftësisë mbajtëse të truallit dhe të ngarkesave të godinës që do të ndërtohet në atë truall.

### **Gërmime për baza dhe themele**

#### Gërmimë

Gërmim dheu për themele ose për punime nëntokësore, deri në thellësinë 1,5 m nga rrafshi i tokës, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të thatë ose të lagur (argjilë edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gurë etj.) duke përfshirë prerjen dhe heqjen e rrënjëve, trungjeve, gurëve, dhe pjesëve me volum deri në 0.30 m<sup>3</sup>, plotësimin e detyrimeve në lidhje me ndërtimet e nëndheshme si kanalet e ujërave të zeza, tubacionet në përgjithësi etj..

#### Mbushjet

Shtresë me gurë dhe copa tulle të zgjedhura, në shtresa të ngjeshura mirë, të pastruara nga pluhuri, suvaja dhe materialet organike, që rezultojnë nga prishjet e përshkruara në artikujt e



mësipërm. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishjet, do të kontrollohen më parë nga Supervizori dhe ripërdorimi i tyre do të autorizohet nga ai.

Përdorimi i materialit të gërmuar

Materiali i përshtatshëm dhe materiali i rimbushur nga punë të përkohshme do të përdoren për rimbushje. Çdo material i tepërt do të jetë në dispozicion të mungesave të materialeve të kërkuara.

Mbushja rreth strukturave

Materiali duhet vendosur në mënyrë simultane në të dyja anët e mbajtëses mur apo shtyllë. Mbushjet e mëvonshme të nxirren nga një material i aprovuar nga Supervizori, duke hedhur me shtresa me trashësi 150 mm me ngjeshje.

### **Themele standarte**

Themele me beton

Themele dhe bazamente ndërtesash prej butobetoni, i formuar me beton dhe gurë gëlqeror më e vogël se 20 cm në raporte për  $m^3$ : beton M 100,  $0.77 m^3$  dhe gurë  $0.37 m^3$ , me dozim të betonit për  $m^3$  si tek betonët, duke përfshirë kallëpet, përforcimet dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e themeleve dhe realizimin e tyre.

### **Hedhja e betonit**

Hedhja e betonit të prodhuar në vend bëhet sipas mundësive dhe kushteve ku ai do të hidhet. Në përgjithësi për këtë qëllim përdoren vinçat fiks që janë ngritur në objekt si dhe autohedhëse. E rëndësishme në procesin e hedhjes së betonit në vepër është koha nga prodhimi në hedhje, e cila duhet të jetë sa më e shkurtër. Gjithashtu, një rëndësi të veçantë në hedhjen e betonit ka edhe vibrimi sa më mirë gjatë këtij procesi.

### **Realizimi i bashkimeve**

Betonimet duhet të kryhen pa ndërprerje n.q.s. kjo gjë është e mundur. Në rastet kur kjo nuk është e domosdoshme ose e detyruar, atëherë duhet të merren të gjitha masat për të realizuar bashkimin e dy betonimeve të kryera në kohë të ndryshme.

Ndërprerja e punimeve të betonimit të vendoset sipas mundësive duke realizuar:

- Lllamarinë me gjerësi 10 cm dhe trashësi 4 mm, nga të cilat 5 cm futen në betonin e freskët dhe betonohen, ndërsa 5 cm e tjera shërbejnë për betonimin e mëvonshëm.
- Shirit fuge, i cili duhet të vendoset sipas specifikimeve të prodhuesit.

### **Betoni në kushte të vështira atmosferike**

Rekomandohet që prodhimi dhe hedhja e betonit në objekt të mos realizohet në kushte të vështira atmosferike.



Ndalohet prodhimi dhe hedhja e betonit në rast se bie shi i rrëmbyeshëm, pasi nga sasia e madhe e ujit që i futet betonit largohet çimentoja dhe kështu që betoni e humb markën që kërkohej.

Në rastet e temperaturave të ulta nën 4 °C rekomandohet të mos kryhet betonimi, por n.q.s kjo është e domosdoshme, atëherë duhet të merren masa që gjatë procesit të prodhimit të betonit, atij t'i shtohet solucioni ndaj ngricave në masën e nevojshme që rekomandohet nga prodhuesi i këtij solucioni. Prodhimi dhe përpunimi i betonit në temperatura të larta mund të ndikojë negativisht në reagimin kimik të çimentos me pjesët e tjera të betonit. Për këtë arsye ai duhet ruajtur kundër temperaturave të larta. Mënyra e ruajtjes nga temperatura e lartë mund të bëhet në atë mënyrë, që betoni i freskët të mbrohet nga dielli duke e mbuluar me plasmas, tallash dhe duke e stërkatur me ujë. Një ndihmë tjetër për përpunimin e betonit në temperatura të larta është të ngjyrosësh mbajtësit e ujit me ngjyrë të bardhë dhe të sigurojë spërkatje të vazhdueshme me ujë.

#### *Tuba dhe dalje*

Tubat si dhe kanalet e ndryshme që e furnizojnë një ndërtesë (uji, ujërat e zeza, rrjeti elektrik, etj) duhet sipas mundësisë të mos futen në beton, që mos pengojnë në homogenitetin e pjesëve të betonit të cilat janë projektuar si pjesë bajtëse, elemente betoni. Në rastet, kur ky kusht nuk mund të plotësohet, atëherë duhet konsultuar inxhinieri konstruktor. Për raste kur duhet kaluar nëpër mure ose nëpër pjesë të tjera mbajtëse si psh soletat, atëherë duhet që gjatë fazës së projektimit të merren parasysh këto dalje dhe të planifikohen/llogariten nga inxhinieri konstruktor si dhe të bëhet izolimi i tyre. Po ashtu duhet që gjatë hedhjes së betonit të përgatiten këto dalje, nëpër të cilat më vonë do të kalojnë tubat si dhe kanalet e tjera furnizuese.

#### • **Provat e betonit**

Pasi është prodhuar betoni, ai duhet kontrolluar nëse i plotëson kriteret sipas kërkesave të projektit.

Mbasi të prodhohet ai dhe para hedhjes së tij, duhet marrë një kampion betoni për të bërë testime në laborator dhe rezultatet e laboratorit duhet të dorëzohen tek Supervizori.

### 11. Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre

Lendet e para ndihmese që do të përdoren janë: - Naftë dhe Vajra lubrifikant për makineritë që do të transportojnë dhe do të hedhin në ujë lenden e pare pragurin gëlqeror. - Kamina vetëshkarkues, buldozerë dhe grejfer që do të shërbejnë për vendosjen e gurëve të mëdhenj në ekstremitetet e veprës. - Çakëll për të beret e mundur shtrimin e sheshit

#### *Armatura e përdorur:*

Themel: Armatura vertikale e përdorur është Ø20 dhe Armatura horizontale Ø16

Themele: Armatura vertikale e përdorur është Ø18 dhe Armatura horizontale (stafat) Ø10

Kolona: Armatura vertikale e përdorur është Ø18 dhe Armatura horizontale (stafat) Ø12

Mure: Armatura vertikale e përdorur është Ø14 dhe Armatura horizontale (stafat) Ø12 dhe Ø8

Trarët: Armatura vertikale e përdorur është Ø18 dhe Ø14 dhe Armatura horizontale (stafat) Ø10

Shkallët dhe soletat: Armatura vertikale e përdorur është Ø14 dhe Armatura horizontale (stafat) Ø12

Armaturat janë të vendosura sipas standardeve evropiane në fuqi duke rritur njëkohësisht jo vetëm aftësinë mbajtëse të kolonave por dhe kapacitetin duktil të tyre.

Furnizimi me energji elektrike do të realizohet pas miratimit nga OSHEE. Gjithashtu pika e lidhjes miratohet nga OSHEE. Projektimi i kabinës elektrike është llogaritur për nivel izolacioni 20 kV.

- *Materialet që do të përdoren për punimet në godine:*

Struktura monolite betoni, Hekur betoni periodik, tulla të lehtësuara për ndërtimin e mureve. Hidroizolim do të bëhet me emulsion bitumi dhe 2 shtresa katrama.

Uji do të merret nga linja e ujësjellësit në zonë. Inertet do të jenë prej shkëmbi natyral, energjia elektrike do të merret nga linja e tensionit të ulët që kalon pranë zonës ku do të bëhet ndërtimi. Materialet do të jenë të pajisura me certifikata të cilësisë së materialeve dhe do të kontrollohen para vendosjes në objekt.

## 12. Informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth zonës së projektit.

Ndërtimi i këtij projekti do të sjellë bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të : OSHEE, Ujësjiellës Kanalizime, rrjeti i telefonisë për të bërë të mundur lidhjen e “Ndërtimit të godinës së Bashkisë Divjake” me infrastrukturën për rrjetin e energjisë elektrike, ujin, rrjetin e telefonisë/ internetit dhe shkarkimin e ujrave të ndotura dhe të bardha.

Arsyet për përzgjedhjen e këtij varianti të projektit janë:

1. Zona ndodhet brenda zonës së studiuar
2. Projekti që është zgjedhur është zgjedhur të ketë një ndikim sa më të ulët në mjedisin rreth tij
3. Ndërtimet që mbizotërojnë në zone janë të njëjtit tip me projektin e propozuar nga ne
4. Lidhja me infrastrukturën rrugore është e realizuar do të shtohet vetëm rruga hyrëse për në objekt
5. Zgjidhja funksionale në tërësinë e saj i është përmbajtur kërkesave të investitorit dhe ligjit.

### 13. Informacion për alternativat e marra në konsideratë

Kërkesa për projektin “Ndertimit te godines se Bashkise Divjake” është bërë nga ana e investitorit.

Kjo zone ka zhvillim urban po ashtu ku funksioni kryesor i përdorimit është i fokusuar në fusha të ndryshme si bujqesi, tregëti, banim etj. Zona është e trajtuar nga pikëpamja arkitektonike pasi përgjatë gjithë zonës gjenden objekte të ndërtuara me forma dhe materiale nga më të ndryshme.

Pronat që ndodhen brenda kësaj zone janë me status juridik privat dhe infrastrukture të rrugëve dhe kanaleve ekzistuese.

Gjendja e strukturave është realisht emirepor mund të merret nekonsiderate përmirësimi dhe shtimii tyre neshërbim tefunksioneve primare.

Aktualisht ne zonën nuk kaprezencet e zonave pyjore apo edhet e zonave të mbrojtura natyrore pjeset e sistemit natyror. Mjediset ujore nuk do të impaktohen ngandotjase pse do të merren masa mbrojtëse që gjatë ndërtimit ndikimi të jetë zero.

### 14. Të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë furnizimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre.

#### **Përbërësit e Betonit**

Përbërësit e betonit duhet të përmbajnë rërë të larë ose granit, ose përzierje të të dyjave si dhe gurë të thyer. Të gjithë agregatët duhet të jenë pastruar nga mbeturinat organike si dhe nga dheu. Pjesa kryesore e agregateve duhet të jetë me formë këndore dhe jo të rrumbullakët. Përbërësit e betonit duhet të kenë certifikatën që vërteton vendin ku janë marrë ato.

#### **Çimento**

Kontraktuesi është i detyruar që për çdo ngarkesë çimentoje të prurë në objekt, të paraqesë faturën e blerjes e cila të përmbajë: sasinë, emrin e prodhuesit si dhe certifikatën e prodhuesit dhe shërben për të treguar që çimentoja e secilës ngarkesë është e kontrolluar dhe me analiza sipas standarteve.

Për më shumë detaje në lidhje me markën e çimentos që duhet përdorur në prodhimin e betoneve, shiko në pikën 4.1.4, pasi për marka betoni të ndryshme duhen përdorur marka çimento të ndryshme.

#### **Uji për beton**





Uji që do të përdoret në prodhimin e betonit duhet të jetë I pastër nga substancat që dëmtojnë atë si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe substanca të tjera organike. Në përgjithësi, uji i tubacioneve të furnizimit të popullsisë (uji i pijshëm) rekomandohet për përdorim në prodhimin e betonit.

### **Depozitimi i materialeve**

Depozitimi i materialeve që do të përdoren për prodhimin e betonit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Çimentoja dhe përbërësit duhet të depozitohen në atë mënyrë që të ruhen nga përzierja me materiale të tjera, të cilat nuk janë të përshtatshme për prodhimin e betonit dhe e dëmtojnë cilësinë e tij.
- Çimentoja duhet të depozitohet në ambiente pa lagështirë dhe që nuk lejojnë lagjen e saj nga uji dhe shirat.
- Materialet që do të përdoren për realizimin e këtij objekti do të jenë kryesisht beton arme të cilat do të vendosen në objekt.
- Struktura monolite beton te klasës C20/ 25 do të jenë në sasinë rreth 610m<sup>3</sup>
- Uji do të sigurohet nga rrjeti shpërndarës i ujës-jellësit
- Zhavorr do të sigurohet nga shkëmbinjtë natyralë në zonën afër objektit.
- Do të përdoret energji elektrike ( 12 orë në ditë) sipas proceseve të punës, do të merret nga linja e rrjetit elektrik të OSHEE për zonën afër objektit.
- Klasa e betonit për strukturën vertikale, muret beton- arme është C25/30. Klasa për elementët e tjerë si themelet, trarët, soletat është parashikuar C20/ 25.
- Hekuri i përdorur në objekt është importi I markës S500 me kufi rrjedhshmërie  $f_y = 50$  daN/mm<sup>2</sup>. kjo klasë armature është parashikuar për të gjitha llojet e armaturave të përdorura në objekt ( zgarat, armature gjatësore, armature tërthore)


**Hartoi**

**CEC.group.shpk**

**Ing.Vangjush MBRICE**



## RELACION TOPOGRAFIK



PROJEKT ZBATIMI :

**“NDERTIMI I GODINES SE BASHKISE DIVJAKE”**

INVESTITORI:

**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**

VENDNDODHJA:

**QYTETI DIVJAKË, BASHKIA DIVJAKË**

PROJEKTUES:

**CEC GROUP sh.p.k**

**Tirane 2020**

## STUDIMI TOPOGRAFIK

1-Hyrje Punimet gjeodezike dhe topografike per rehabilitimin e “Ndertimit te godines se Bashkise Divjake”, u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjithshme dhe specifike te parashikuara nga investitori. Firma projektuese “CEC GROUP” organizoi punen dhe kreu punimet ne baze te pervojës se perfituar ne punimet e meparshme te kesaj natyre.

Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese. Per te siguruar lidhjen gjeodezike unike te te gjithë projekteve nga firma u shfrytezuan te dhenat gjeodezike te rrjetit shteteror te triangulacionit dhe nivelimit.

Sistemi qe perdor Republika e Shqiperise eshte projeksioni Gauuss Kryger-it me ellipsoid Krasovsky-n. Rilevimi eshte bere ne sistemin nderkombetar me projeksionin UTM me ellipsoid WGS84. Duke patur parasysh zonen dhe ritmin e zhvillimit qe ajo ka, do te ishte me frytedhense nese do te perdorej dhe ky sistem. Me kete sistem mund te percaktohet lehtesisht kordinatat gjeodezike per cdo pike mbi siperfaqen tokesore nepermjet perdorimit te GPS. Gjate rikondicionit ne terren u vendosen pikat e triangulacionit dhe markat e nivelimit ne pikat e fiksuara ne terren. Pikat e fiksuara ne terren u paisen me koordinata ne projeksionin UTM ellipsoid WGS84 dhe kuota.



*Fig.1 Rilevimi i zones ku do te ndertohet objekti*











RELACION TOPOGRAFIK “Ndertimi I godinës së Bashkisë Divjakë”



*Fig.2 Fotografi te godinave egzistuese te Bashkise Divjake.*

Para fillimit te rilevimit u krye pernjohja e detajuar e terrenit, e cila sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes se punes, menyren e ndertimit te rrjetit gjeodezik, poligonometrise se rilevimit, nivelimit teknik si dhe organizimit te punes. Fiksimi ne terren i pikave te rilevimit u krye me kunja hekuri me gjatesi (20- 30cm) te futur toke. Ato jane vendosur ne vende te dukeshme dhe te pa levizshme. Identiteti i tyre eshte fiksuar me boje te kuqe te shkruajtur ne afersi te pikes fikse ne vende te dukeshme nga rruga ekzistuese ose tereni. Ato jane vendosur ne vende te qendrueshme, ne ane te rruges ose afer saj, kane pamje te ndersjellte, duke siguruar ne kete menyre lidhjen dhe vazhdimesine e punes nga faza e projektimit te “Ndertimit te godines se Bashkise Divjake” ne ate te zbatimit te saj.



Stacion Total Leica 307



TRIMBELL M3



Trimble R6 (gps)



TOPCON GPT 900 A



Çdo pike e fiksuar ne terren ka numrin, koordinatat e saj, si dhe lartesine te perftuar nepermjet nivelimit gjeometrik e gjeodezik (shih planimetrite e objekteve ku gjenden koordinatat tre dimensionale te pikave mbeshtetese). Keto te dhena sigurojne gjetjen e tyre me lehtesi ne terren. Pikat fikse te terrenit jane te percaktuara ne planimetrine e vecante te projektit te “Ndertimit te godines se Bashkise Divjake”. Matjet u kryen me GPS TRIMBELL R6, Stacion Total te tipit Leica 307, Stacion Total te tipit Trimble M3, Topcon GPT 900 A si dhe me nivele, te cilet teknikisht sigurojne matjet e kendeve e largesive me saktesine e nevojshme per projektimin e rrugeve. Stacion Total Leica 307 TRIMBELL M3 Trimble R6 (gps) TOPCON GPT 900 A.

Zhvillimi i nivelimit gjeometrik Per te siguruar kerkesat e larta teknike ne punimet rilevuse, u percaktua qe saktesia altimetrike e punimeve topografike te jete e larte dhe per kete qellim u zhvillua nivelim gjeometrik per pikat e poligonometrise ne te gjithë sektoret e rruges. Nivelimi gjeometrik u krye me nivelen teknike te tipit Kern Level, me metoden e nivelimit teknik te dyfishte, duke matur çdo disnivel dy here, me dy vendosje instrumenti. Diferenca midis dy disniveleve te perftuar ne çdo stacion nuk u lejua me teper se 3 mm. 3-Rilevimi i zones Duke u mbeshtetur ne pikat e poligonometrise dhe te nivelimit gjeometrik u zhvillua rrjeti i matjeve topografike te planimetrise se “Ndertimit te godines se Bashkise Divjake”.

RELACION TOPOGRAFIK “Ndertimi I godinës së Bashkisë Divjakë”

Kjo u be e mundur ne bashkepunim me grupin studimor-projektues te konsulentit. Eshte rilevuar çdo objekt ne afersi te zones si rruge, puseta, ndertesa, mure, mure mbajtes, gardhe, objekte te ndryshem, shtylla tensioni, rruge dytesore, trotuare, platforma betoni, bunkere, tubacione etj. Te gjithë objektet e pare ne teren jane hedhur ne relief. Punimet topogjeodezike te kryera jane mbeshitetur ne shkallen e plote te pergatitjes profesionale, ne perdorimin e teknologjive bashkekohore per matjet fushore dhe perpunimin kompjuterik te te dhenave, per te plotesuar kerketat teknike te parashtruara nga projektuesit. Çdo pike e marre ne teren ka koordinata tre dimensionale, te paraqitura ne projekt. Perpunimi i materialit topografik ne zyre eshte bere me programin STRATO dhe LEONARDO, TGO, Autocad Land Development nga ku eshte perftuar relievi i zones . Ky relief sherbeu per hartimin e projektit te zbatimit me saktesine dhe cilesine e kerkuar ne termat e references nga investitori. Ne materialin grafik te projektit jepet planimetria e fiksimeve dhe tabela e koordinatave te pikave te vendosura ne terren.

- Pershkrimi i punes ne terren Per mbeshitetjen e punimeve fillimisht u krijuan 2 pika te forta te cilat jane te mjaftueshme per kryerjen e pikave detaje te rilevimit perderisa jane ne 1 km. Matja e ketyre pikave u krye me metoden statike duke qendruar ne pike rreth 40 min ne intervalin 1 sek duke siguruar saktesi milimetrike te koordinatave te pikave. Rilevimi i trupit te rruges egzistuese si dhe te gjithë elementeve me largesi rreth 15m nga aksi u krye me metoden 'stop & go'. Prania e marresit baze ne largesi te kufizuar siguron saktesi me te larte te matjeve ne interval kohe me te shkurter. Keshtu per pikat deri ne 1km nga marresi baze u perdor intervali 10 sek me matje per çdo sekonde ndersa per largesi me te madhe deri ne 2km intervali 15 sek. Element kryesor ne matjen 'stop & go' eshte mos humbja e lidhjes se fazes bartese gje e cila prish zgjidhjen perfundimtare. Kjo mund te realizohet duke shmager futjen ne zona hije te sinjalit ose zona me reflektim te madh sinjali. Ne kete rast marresit TRIMBLE R6 japin nje sinjal i cili lajmeron matesin se duhet te rifillojne matjen nga nje pike e matur paraprakisht, duke siguruar saktesine e kerkuar. Ne zonat me dendesi ndertimesh u perdor Stacioni Total pasi kishte peme dhe ndertime te larta te cilat nuk lejojne matjen e pikave detaje me GPS.





**Horografia**

**Pika A**

| Sistemet koordinative                    | Easting          | Northing         |
|------------------------------------------|------------------|------------------|
| ETRS89                                   | 19° 31' 50.2243" | 40° 59' 36.2655" |
| UTM Zone 34N                             | 376408.48        | 4539064.89       |
| Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4      | 4376489.55       | 4541012.19       |
| KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator | 460504.45        | 4539947.25       |

**Pika B**

| Sistemet koordinative                    | Easting          | Northing         |
|------------------------------------------|------------------|------------------|
| ETRS89                                   | 19° 31' 51.5955" | 40° 59' 36.6227" |
| UTM Zone 34N                             | 376440.71        | 4539075.36       |
| Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4      | 4376521.78       | 4541022.67       |
| KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator | 460536.56        | 4539958.09       |



**Pika C**

| Sistemet koordinative                    | Easting          | Northing         |
|------------------------------------------|------------------|------------------|
| ETRS89                                   | 19° 31' 50.5816" | 40° 59' 35.1432" |
| UTM Zone 34N                             | 376416.25        | 4539030.13       |
| Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4      | 4376497.31       | 4540977.42       |
| KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator | 460512.62        | 4539912.58       |


**Pika D**

| Sistemet koordinative                    | Easting          | Northing         |
|------------------------------------------|------------------|------------------|
| ETRS89                                   | 19° 31' 52.0397" | 40° 59' 35.3545" |
| UTM Zone 34N                             | 376450.43        | 4539036.08       |
| Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4      | 4376531.50       | 4540983.37       |
| KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator | 460546.73        | 4539918.92       |

**PROJEKTUES: C.E.C GROUP SH.P.K**

**NR.LIC.N.6635/8**

## RELACION TEKNIK KONSTRUKTIV



PROJEKT ZBATIMI :  
***“NDERTIMI I GODINES SE BASHKISE DIVJAKE”***

INVESTITORI:  
***FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT***

VENDNDODHJA:  
***QYTETI DIVJAKË, BASHKIA DIVJAKË***

PROJEKTUES:  
***CEC GROUP sh.p.k***

***Tirane 2020***

## TE DHENA TE PERGJITHSHME

Godina e re e bashkise do te ndertohet ne token shtet midis rrugeve

Rruga Italia ne veri , Rruga Vikthi ne jug dhe Perendim dhe rruga e re qe do te ndertohet si segment i rruges Italia ne Lindje.

Koncepti për godinën e re përbëhet nga dy trupa që nderveprojnë me njeri tjetrin duke shfaqur formën katrore me dimensione te jashtme 45m me drejtimin Lindje –Perendim dhe 34.1 m në drejtimin Veri-Jug.

Godina e re është organizuar në 3 kate dhe me një kat nëntokë.

**Kati Nëntoke** ka një sipërfaqe ~1151.16 m<sup>2</sup>. Në të janë përfshire funksionet si ,magazininim me sipërfaqe ~ 34.71 m<sup>2</sup> dhe parkim për administratën dhe publike~ 1116.45 m<sup>2</sup>.

**Ne Katin Perdhe** janë organizuar shërbimet e shpejta, kontakti dhe pritja e qytetareve.

Kati përdhe ka nje sipërfaqe ~ 506.34 m<sup>2</sup>.

**Kati i Pare** me nje sipërfaqe~ 929.24 m<sup>2</sup>dhe **Kati i Dyte**me një sipërfaqe ~ 919.13 m<sup>2</sup>janë në funksion të Administrates dhe Keshillit të Bashkisë, me zyra dhe ambjentet përkatëse.

Ndërthurja e dy trupave krijon në qendër një atrium, pra një hapësirë të lirë të përbashkët qëndrore me dimensione 27.5 m me 21.1 m dhe sipërfaqe 577.5 m<sup>2</sup>do të përdoret si hapësirë që do të shfrytëzohet për administratën dhe banorët në raste organizimi evenimentesh .

Hyrja për në objekt do të realizohet nëpërmjet një rampe përnë kati nëntoke dhe 3 nje shkalle ashensor për katin e parë dhe të dytë të administratës. Shkallët janë të vendosura me distanca që respektojnë kushtet e evakuimit në raste zjarri dhe do të shërbejnë edhe si shkalle emergjence. Godina do të jetë e aksesueshme me rrugë shërbimi në të gjitha anët. Rruga kryesore në anën veriore përballë sheshit qendror dhe rruge shërbimi përgjatë anës lindor që lidhet me rrugën ekzistuese në anën jugor, gjithashtu lidhet edhe me rrugën ekzistuese në anën perendimor ku jane të organizuar parkimi i hapur bashkë me lulishten dhe hapësirat e lira për banorët.Planifikohet ndertimi i vetem nje segmenti rrugor me gjatesi 100 ml ne krahun lindor te objektit.

Objekti i konceptuar në formëkatrore, në katin perdhe transparent dhe dy katet e tjera te trajtuara me fasade të ajrosur pjeserisht dhe pjeserisht me material terrakote krijojne nga pikpamja arkitektonike objektin simbol per te gjithë qytetin. Ndarjet e ambienteve të brendshme do të realizohen me mure kartoxhesi të izoluar me fiber xhami ndërsa ana nga korridori ku jane pozicionuar zyrat do të jenë me fasade xhami për të krijuar transparence dhe komunikim viziv te zyrave me pjesën e jashtme të objektit. Tavanetdo të realizohen me kartonxhes ku në të do të kalojnë impiantet elektrike të ndriçimit dhe kondicionimi.Fasada e zyrave është e gjitha me xham

dhe hijezimi do të realizohet nëpërmjet panelave të aluminit model 'brisolet'.

Objekti nuk do të shërbejë vetëm si godinë në funksion të shërbimeve por dhe si njëvlerë e shtuar për peisazhin e sheshit qendror dhe të qytetit në tërësi. Përdorimi i sistemeve inovative siç janë fasada e venteluar, mireizolimi termik me hidrik, sistemi qendror i kondicionimit i të gjithë objektit do të ndihmojë jo vetëm në rritjen e efikasitetit energjetic por do sjellin kursime të konsiderueshme në buxhin e bashkisë dhe mirëmbajtjen në afat të gjatë.

### ANA KONSTRUKTIVE E NDERTIMIT

Skema strukturore e kësaj godine do të jetë me kolona me permasa 40x60cm si dhe trarët e cilët do të kenë permasa 40x60cm. Soletat do të realizohen me traveta të cilat do të mbështeten tek trarët mbajtës.

#### **Betoni në kushte të vështira atmosferike**

Rekomandohet që prodhimi dhe hedhja e betonit në objekt të mos realizohet në kushte të vështira atmosferike.

Ndalohet prodhimi dhe hedhja e betonit në rast se bie shi i rrëmbyeshëm, pasi nga sasia e madhe e ujit që i futet betonit largohet çimentoja dhe kështu që betoni e humb markën që kërkohej.

Në rastet e temperaturave të ulta nën 4 °C rekomandohet të mos kryhet betonimi, por nëq.s kjo është e domosdoshme, atëherë duhet të merren masa që gjatë procesit të prodhimit të betonit, atij t'i shtohet solucioni ndaj ngjicave në masën e nevojshme që rekomandohet nga prodhuesi i këtij solucioni. Prodhimi dhe përpunimi i betonit në temperatura të larta mund të ndikojë negativisht në reagimin kimik të çimentos me pjesët e tjera të betonit. Për këtë arsye ai duhet ruajtur kundër temperaturave të larta. Mënyra e ruajtjes nga temperatura e lartë mund të bëhet në atë mënyrë, që betoni i freskët të mbrohet nga dielli duke e mbuluar me plasmas, tallash dhe duke e stërkatur me ujë. Një ndihmë tjetër për përpunimin e betonit në temperatura të larta është të ngjyrosësh mbajtësit e ujit me ngjyrë të bardhë dhe të sigurojë spërkatje të vazhdueshme me ujë.

#### *Tuba dhe dalje*

Tubat si dhe kanalet e ndryshme që e furnizojnë një ndërtesë (uji, ujërat e zeza, rrjeti elektrik, etj) duhet sipas mundësisë të mos futen në beton, që mos pengojnë në homogenitetin e pjesëve të betonit të cilat janë projektuar si pjesë mbajtëse, elemente betoni. Në rastet, kur ky kusht nuk mund të plotësohet, atëherë duhet konsultuar inxhinieri konstruktor. Për raste kur duhet kaluar nëpër mure ose nëpër pjesë të tjera mbajtëse si p.sh soletat, atëherë duhet që gjatë fazës së projektimit të merren parasysh këto dalje dhe të planifikohen/llogariten nga inxhinieri konstruktor si dhe të bëhet izolimi i tyre. Po ashtu duhet që gjatë hedhjes së betonit të përgatiten këto dalje, nëpër të cilat më vonë do të kalojnë tubat si dhe kanalet e tjera furnizuese.

#### **• Provat e betonit**

Pasi është prodhuar betoni, ai duhet kontrolluar nëse i plotëson kriteret sipas kërkesave të projektit.

Mbasi të prodhohet ai dhe para hedhjes së tij, duhet marrë një kampion betoni për të bërë testime në laborator dhe rezultatet e laboratorit duhet të dorëzohen tek Supervizori.

#### **a. Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre**

Lendet e para ndihmese që do të përdoren janë: - Naftë dhe Vajra lubrifikant për makineritë që do të transportojnë dhe do të hedhin në ujë lenden e pare pragurin gëlqeror. - Kamina vetëshkarkues, buldozerë dhe grejfer që do të shërbejnë për vendosjen e gurëve të mëdhenj në ekstremitetet e veprës. - Çakëll për të beret e mundur shtrimin e sheshit

*Armatura e përdorur:*

Themel: Armatura vertikale e përdorur është Ø20 dhe Armatura horizontale Ø16

Pilota: Armatura vertikale e përdorur është Ø18 dhe Armatura horizontale (stafat) Ø10

Kolona: Armatura vertikale e përdorur është Ø18 dhe Armatura horizontale (stafat) Ø12

Mure: Armatura vertikale e përdorur është Ø14 dhe Armatura horizontale (stafat) Ø12 dhe Ø8

Trarët: Armatura vertikale e përdorur është Ø18 dhe Ø14 dhe Armatura horizontale (stafat) Ø10

Shkallët dhe soletat:: Armatura vertikale e përdorur është Ø14 dhe Armatura horizontale (stafat) Ø12

Armaturat janë të vendosura sipas standardeve evropiane në fuqi duke rritur njëkohësisht jo vetëm aftësinë mbajtëse të kolonave por dhe kapacitetin duktil të tyre.

Furnizimi me energji elektrike do të realizohet pas miratimit nga OSHEE. Gjithashtu pika e lidhjes miratohet nga OSHEE. Projektimi i kabinës elektrike është llogaritur për nivel izolacioni 20 kV.

#### **• Materialet që do të përdoren për punimet në godine:**

Struktura monolite betoni, Hekur betoni periodik, tulla të lehtësuara për ndërtimin e mureve, panele sandwich për mbulimin e çatise (kapanoni), konstruksion metalik për mbulesën e kapanonit, shtrese fino etj. Hidroizolim do të bëhet me emulsion bitumi dhe 2 shtresa katrama. Uji do të merret nga linja e ujësjellësit në zonë. Inertët do të jenë prej shkëmbi natyral, energjia elektrike do të merret nga linja e tensionit të ulët që kalon pranë zonës ku do të bëhet ndërtimi. Materialet do të jenë të pajisura me certifikata të cilësisë së materialeve dhe do të kontrollohen para vendosjes në objekt.

#### **Përbërësit e Betonit**

Përbërësit e betonit duhet të përmbajnë rërë të larë ose granil, ose përzierje të të dyjave si dhe gurë të thyer. Të gjithë agregatët duhet të jenë pastruar nga mbeturinat organike si dhe nga dheu. Pjesa kryesore e agregateve duhet të jetë me formë këndore dhe jo të rrumbullakët. Përbërësit e betonit duhet të kenë çertifikatën që vërteton vendin ku janë marrë ato.

#### **Çimento**

Kontraktuesi është i detyruar që për çdo ngarkesë çimentoje të prurë në objekt, të paraqesë faturën e blerjes e cila të përmbajë: sasinë, emrin e prodhuesit si dhe çertifikatën e prodhuesit dhe shërben për të treguar që çimentoja e secilës ngarkesë është e kontrolluar dhe me analiza sipas standarteve.



Për më shumë detaje në lidhje me markën e çimentos që duhet përdorur në prodhimin e betoneve, shiko në pikën 4.1.4, pasi për marka betoni të ndryshme duhen përdorur marka çimento të ndryshme.


### **Uji për beton**


Uji që do të përdoret në prodhimin e betonit duhet të jetë I pastër nga substancat që dëmtojnë atë si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe substanca të tjera organike. Në përgjithësi, uji i tubacioneve të furnizimit të popullsisë (uji i pijshëm) rekomandohet për përdorim në prodhimin e betonit.

### **Depozitimi i materialeve**


Depozitimi i materialeve që do të përdoren për prodhimin e betonit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Çimentoja dhe përbërësit duhet të depozitohen në atë mënyrë që të ruhen nga përzierja me materiale të tjera, të cilat nuk janë të përshtatshme për prodhimin e betonit dhe e dëmtojnë cilësinë e tij.
- Çimentoja duhet të depozitohet në ambiente pa lagështirë dhe që nuk lejojnë lagjen e saj nga uji dhe shirat.
- Materialet që do të përdoren për realizimin e këtij objekti do të jenë kryesisht beton arme të cilat do të vendosen në objekt.
- Struktura monolite beton te klasës C20/ 25 do të jenë në sasinë rreth 610m<sup>3</sup>
- Uji do të sigurohet nga rrjeti shpërndarës i ujësjellësit
- Zhavorr do të sigurohet nga shkëmbinjtë natyralë në zonën afër objektit.
- Do të përdoret energji elektrike ( 12 orë në ditë) sipas proceseve të punës, do të merret nga linja e rrjetit elektrik të OSHEE për zonën afër objektit. Rreth 2680 kë/orë
- Klasa e betonit për strukturën vertikale, muret beton- arme është C25/30. Klasa për elementët e tjerë si themelet, trarët, soletat është parashikuar C20/ 25.
- Hekuri i përdorur në objekt është importi I markës S500 me kufi rrjedhshmërie  $f_y = 50$  dan/mm<sup>2</sup>. kjo klasë armature është parashikuar për të gjitha llojet e armaturave të përdorura në objekt ( zgarat, armature gjatësore, armature tërthore)





Plani I strukturave ne kuoten +4.94




Plani I strukturave ne kuoten +9.44

### • THEMELET

- Thellesia e vendosjes se themeleve percaktohet nga studimi gjeologjik dhe rekomandimet e specialisteve si dhe nga rilevimi I sheshit te ndertimit. Bazamenti I objektit do te realizohet nje pjese me plinta dhe nje pjese me pllake.


Ato do te jene prej beton/armeje me dimensione: Pllaka 41x35.1m  
Plintat 2x2m




Plan i pllakes se themelit

Armimi i pllakes se themelit eshte reaalizuar me dy dopio zgara fi16mm.






Armimi i pllakes-zgara sipër




Armimi i pllakes –zgara poshte


### Armimi i pllakes (Prerja A-A)




### Armimi i pllakes (Prerja B-B)




### Armimi i pllakes –Prerjet




### Dimensionimi i plintit 1



Armimi i plintit 1



Armimi i kolones rrethore D50cm



Armimi i kolones 40x60cm


Kolonat Strukturore te godines jane tre tipe:

- Kolona drejtkendore 40x60cm
- Kolona rrethore D=50cm.
- Kolona rrethore D=40cm.

Traret e Godines jane me permasa 40x60cm.




## Armimi i traut 1



## Armimi i trareve


- Mbulesa ne kuoten +14.00 do te realizohet me solet beton/armeje si dhe me traret perkates.



**PROJEKTUES: C.E.C GROUP SH.P.K**  
**Nr.Lic.N.6635/8**

# RAPORT TEKNIK PER MBROJTJEN NGA ZJARRI

**Ndertimi I godinës së Bashkisë Divjakë.**



**Tirane 2020**

## **Te dhena te pergjithshme**

**OBJEKTI** do te sistemohet e do te shtrohet me rruge e drenazhime per kullimin e ujrave , me shkalle , me dalje emergjence , ku do te vendosen. Hidrante zjarri te jashtem. I gjithë sheshi ku do te ndertohet godina eshte sistemuar sipas rregullave te urbanistikes dhe sherbimit zjarrfikese. Godina ne perberje do te pershkohe rreth e rrotull saj me rrugica te cilat bejne te mundur manovrimin e lirshem te makinave zjarrfikese dhe atyre teurgjences.

Hyrja per ne godine do te behet nepermjet hyrjes nga pas te objektit e cila eshte 3-4m egjere.

Ne vendosjedhe ne largesite midis objekteve te tjera nuk ka shkelje te normave te mbrojtjes nga zjarri.

### **Siguria nga zjarri në godina industriale**

Ashtu si ne çdo objekt, menaxhimi i kesaj godine,duhet të njohe se **standardet e sigurisë** duhet të reflektojnë një kulturë të sigurisë në godina. Siguria nga zjarri ne godina industriale është një konsideratë e rëndësishme per projektimin dhe ndërtimin e tyre..

Për deri sa çdo object është I ndryshem dhe **siguria nga zjarri** ajo mund të ndahet gjerësisht ne tri zona:

#### **1-Evakuimi**

- Evakuimi I nje numri te madhe njerezish nga objekti duhet te realizohet shpejt dhe me lehtësi.

-Vendi duhet të jetë I projektuar për të siguruar që çdo zjarr mund të përfshihet në një zone të vogël, duke zvogëluar numrin e personave në rrezik.

-Sinjalistika e daljet e zjarrit dhe të sigurisë nga zjarri duhet të jenë evidente.

#### **2-Parandalimin e zjarrit**

- Çdo aspect I projektimit dhe ndërtimit duhet të zbatohet me parandalimin e zjarrit në mendje. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për çdo ambient, si dhe fusha të ndriçimit e cila do të përfshijë sasi të mëdha të energjisë elektrike.

#### **3-Përballja me një zjarr**

- Sigurohuni që ju keni aparatet e duhura për te fikur zjarrin me disa lloje të ndryshme te paisjeve te fikjes se zjarrit në të gjithë objektin. Ajo gjithashtu do të jetë një ide e shkëlqyer per te minimizuar zjarret.

***Ne keto kushte, ky object dhe per rrjedhoje edhe infrastruktura per rreth tij, I ploteson largesite e mbrojtjes nga zjarri, te percaktuara ne normat perkatse. Ne rast zjarri automjetet zjarrfikese mund te afrohen ne object nga te gjitha anet.***

***Mbeshtetja ligjore dhe normative***

Ne masat e parashikuara per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin jane marre parasysh: Siguria e jetes se njerezve pra ne kesaj godine ne rast renie zjarri ne cdo kohe dhe mjedise.

Kjo realizohet nepermjet zbatimit te kerkesave ligjore dhe normative te percaktuara per kete kategori veprimtarije .

Konkretisht:

-Ligji nr.8766 date 05.04.2001 "Per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin"

-Rregullore "Mbi masat e mbrojtjes nga zjarri ne projektimin e objekteve te cdo lloji"

-Normat per kompletimin e objekteve me mjetet e diktimit sinjalizimit dhe te shuarjes se zjarreve .

-Normat per evakuimin e detyruar te objekteve ne raste zjarri.

### **Niveli rrezikut.**

Ambientet e kesaj godine qe ne projektim duhet te jene te sistemuara dhe rregulluara sipas normave te funksionimit te sigurise nga zjarri ne godina industriale dhe ne baze te normave dhe rregullave te mbrojtjes nga zjarri si dhe te rregullores te objekteve akomoduese ne Republiken e Shqiperise. Si materiale te djegshme te pranishme pergjithesisht jane ato prej druri, plastike, leter e karton dhe sidomos sistemi i ndricimit.

***Sipas madhesise te ngarkeses specifike dhe natyres se veprimtarise, kemi te bejme me nivel normal.***

#### **a) Faktoret me ndikim negative.**

Ne kushtet e nje zjarri te mundshem nga faktoret e jashtem ,jeta e njerezve te pranishem ne godine rrezikohen nga temperaturat e larta, nga ulja e perqindjes se oksigjenit ne ambjent, nga humbja e te parit dhe toksikimi.

Te gjitha keto jane te lidhura me vetite fiziko-kimike te lendeve te djegeshme te pranishme dhe me sasine e tyre .

### **Materialet me perberje plastike**

Edhe materialet me perberje plastike qe ndodhen ne godina industrialeparaqesin rrezik ne perhapjen dhe ne zhvillimin e zjarreve eventual. Kjo ndodh pasi plastikat ndizen dhe digjen lehtesisht. Gjate djegies se plastikave temperatura e tyre arrin nga 1100°C deri 1200°C. Shume material plastike, gjate djegies se tyre clirojne avuj dhe gaze helmuese te cilat jane te demshme per pjesmarresit ne godine.

Produktet e djegies perbejne rrezik jo vetem per perhapjen e zjarrit por edhe per jeten e njerezve te pranishem, pasi tymosen ambjentet.

#### **b) faktoret me ndikim pozitiv.**

Kjo godine, me perjashtim te sistemit te ndricimit eshte me element konstruktiv te pa djegshem. Ne ambjentet e brendeshme zjarri mund te lind dhe te zhvillohe tvetem ne lendet dhe materialet e djegshme qe ndodhen ne ndricuesit e godines . Strukturat ndertimore te godines nuk digjen. Ato i qendrojne zjarrit pa u shkaterruar, ne nje afat kohor qe eshte i barabarte me kufirin minimal te



qendrueshmerise ndaj zjarrit qe ka secila structure ndertimore e saj. Brenda kesaj kohe njerezit kane mundesi te largohen nga godina pa rrezikuar jeten e tyre dhe njeherazi te veprohet me efektivitet per shuarjen e tij.

Zgjidhja planimetrike e godines eshte me hyrje komunikuese te vecanta me hapesira te lira dhe te konsiderueshme per evakuimin ne rastezjarri qofte dhe nga faktore te jashtem, garanton evakuimin ne kohe dhe pa rrezik te njerezve te ndodhur brenda ne godine.

Siguria e evakuimit garantohej edhe nga qendrueshmeria kundrejt zjarrit qe kane konstruksionet dhe dalja per evakuim.

Kjo veprimtari nuk lejon shkaqe qe te lindin burime nxehtesie dhe qe keto burime nxehtesie te bien ne kontakt me lendet e djegshme te pranishme ne ndertese.

Instalimi dhe kompletimi mjediseve me sisteme diktim sinjalizimi me kamera vzhgimi, me mjete dhe pajisje efektive shuarese, me plane emergjence dhe me plane evakuimi e te tjera, e rrisin sigurine ne kete drejtim.

Puna e kujdesshme e stafit te godines , kerkesa dhe kontrolli per zbatimin e rregullave dhe normave, trajnimi i tyre per njohjen dhe perdorimin e mjeteve shuarese ne perdorim jane gjithashtu nje siguri me shume.

Instalimet elektrike nuk perbejne shkak per renien e ndonje zjarri, pasi ato jane parashikuar dhe duhet te realizohen konform normave teknike, ne pershtatje me natyren e ambjenteve dhe me rezerva te konsiderueshme per mbajtjen e ngarkeses. Sistemi elektrik duhet te kete boks me vete me kontatore. Percjellesit duhet te jene kabell bakri me izolim dhe veshje PVC, **me material anti zjarr..**

### **Qendrueshmeria kundrejt zjarrit dhe grupi i djegshmerise**

Normat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit, godinat industriale i lejojne te jene minimalisht te shkalles se I-re,II-te dhe III-te te qendrueshmerise ndaj zjarrit.

***Pra qendrueshmeria e kerkuar kundrejt zjarrit e kesaj godinete normohet te jete e shkalles se III-te, qe eshte dhe shkalla me e disfavorshme e pranueshme nganorma.***

#### **1- Grupi i kerkuar idjegeshmeriset e strukturave ndertimore**

Per shkallen e III - te te qendrueshmerise ndaj zjarrit te percaktuar me larte, grupi I kerkuar I djegeshmerise te struktura vete saj duhet te jete : ***te gjitha struktura ndertimore normohet te jene te padjegshem.***

### **Kushtet e sigurise ndaj zjarrit.**

Duke I krahasuar te dhenat faktike me ato te kerkuara sipas normes, te cilat jane parashtruar me lart, mund te konkludojme :

- 1- Grupi faktik i djegeshmerise i strukturave te ndertimit dhe i vetegodines eshte me i larte se ai inormuar.
- 2- Kufiri minimal faktik i qendrueshmerise ndaj zjarrit i strukturave te godines eshte me i larte se kufiri minimal i qendrueshmerise i normuar.
- 3- Shkalla faktike e qendrueshmerise ndaj zjarrit e godines eshte me e larte se shkalla e normuar.

#### ***Si perfundim theksojme se :***

***Plotesohen te gjitha kushtet e sigurise nga zjarri, sipas kerkesave dhe gjendjes ne fakt te zbatimit te normave te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit.***

### **Evakuimi i detyruar i njerezve ne rast zjarri.**

Ne kete godine, si dalje per evakuimine detyruar te njerezve te pranishem ne rast zjarri jane hyrjet kryesore ne godine te cilat jane me dimensione mbi 120 – 150 cm, sic parashikohet nga normat e sigurise ndaj zjarrit.

Me keta tregues jemi brenda kerkeses te normave te mbrojtjes nga zjarri per evakuimin e detyruar te njerezve ne rastzjarri.

Evakuimi i detyruar i njerezve nga godina duhet te realizohet pa arritur faza kritike, pra braktisja e godines prej tyre duhet te behet brenda 5-6 minutave.

Gjatesia maksimale faktike e rruges per evakuim nga vendi me i larget i ndodhjes se njerezve deri te dalja evakuese me e afert :

Normat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit, gjatesine e rrugeve te evakuimit ne te tilla godina dhe ne te tilla aktivitete e lejojne deri ne 40 metra.

Duhet theksuar se zgjidhja konstruktive dhe planimetria e godines eshte e tille qe nuk krijon pengesa ne rruget dhe daljet evakuese, garantojne ritem normal te levizjes se njerezve gjate braktisjes se godines, nuk lejojne tymosjen e shpejte te rrugeve dhe daljeve te planifikuara per evakuim, vecanerisht ne fazen e pare te zhvillimit te zjarrit.

### **Mjetet dhe pajisjet e diktim sinjalizimit dhe shuarjes se zjarreve.**

#### **Furnizimi me uje**

Per shuarjen e zjarreve eventual dhe per nevojat hidro sanitare duhet te ndertohet nje sistem ujsjelles i kompletuar me depozita uji , elektro pompa e cila duhet te jete e fuqishme qe te jape 200- 400 litra uje ne min dhe te realizoje nje presion 5 bar per furnizimin e hidranteve te zjarrit ,hidrante te cilet duhet te jene mbitokesor.

### **Hidranti zjarrfikes**

Ne hyrje te godines duhet te vendoset hidrant zjarrfikesish per furnizimin me uje te makinave zjarrfikes ne raste zjarri .Sipas normes duhet te instalohet ne nje cep te fushes godines Hidrant zjarri nentokesor me dimesion 50mm. Hidranti te jete i tipit DN 50mm.Furnizimi me uji i hidranteve te behet nga depozita e vendosur jashte ambinteve te godines,nepermjetpompes.

### **Diktim sinjalizimi i zjarreve**

Ambientet e godines jane te mbrojtura me sistem diktim sinjalizimi per zjarret eventuale .Dedektoret te vendosen ne tavanin e ketyre ambienteve dhe te jene te tipit tetymit.

Gjithashtu ketu duhet te vendoset edhe nje sinalizues elektrik manual, me pulsant dhe me zile per te dhene sinjalin ne raste zjarri apo emergjenca te tjera.

### **Fiksi i dores**

Ne hyrjen e godines dhe ne kabinen elektrike te ndodhur ne keto ambiente,duhet te vendosen 2 fikes dore te tipit me pluhur ABCD me kapacitet 9-12 kg.

Fiksate jane lehtesisht te perdorshem ne raste zjarri.

### **Te vecanta**


Ambientet e godineste cilat do te funksionojne per administraten . duhet te vendosen dalje emergjence, tabelat evakuese me ndricim fosforishent ne ambientet e brendshme per evakuimin e detyruar te njerezve .Nepermjet tyre tregohet drejtimi i levizjes per braktisjen e detyruar te godines ne raste zjarri.

Godina duhet te kete rregulla te brendshme per parandalimin e zjarreve dhe plan veprimi per rastet e renies se zjarreve .

Ne vende te dukshme duhen afishuar dhe numrat e telefonit te stacionit zjarrfikes  
**( Telefono “128” pa pagese ne raste zjarri ).**

**PROJEKTUES: C.E.C GROUP SH.P.K**  
**NR.LIC.N.6635/8**

# RELACION I SISTEMIT TE NGROHJE-FTOHJES



**PROJEKT ZBATIMI :**  
**“NDERTIMI I GODINES SE BASHKISE DIVJAKE”**

**INVESTITORI:**  
**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**

**VENDNDODHJA:**  
**QYTETI DIVJAKË, BASHKIA DIVJAKË**

**PROJEKTUES:**  
**CEC GROUP sh.p.k**

**Tirane 2020**

## **Planimetria e vendndodhjes së projektit**

Objekti i ri i bashkise eshte i konceptuar si objekti i ndertuar ne dy trupa te organizuar ne forme katrore me dimensione te jashtme 45m me drejtimin Lindje –Perendim dhe 34.1 m ne drejtimin Veri-Jug. Do te kete 4 kate nga te cilet 1 eshte i ndertuar nentoke me funksion parkim per administraten dhe publik. Ne katin perdhe do te organizohen sherbimet dhe kontakti me qytetaret nderta dy katet e sipërme do te jene ne funksion te administrates dhe keshillit bashkia. Nderthurja e ketyre dy trupave krijone nje hapsire te lire te perbashket ne qender me dimensione 27.5 m me 21.1 m dhe sipërfaqe 577.5 m<sup>2</sup> qe do te perdoret si hapsire qe do te shfrytezohet nga administrata dhe qyteti ne raste evenimentes. Objekti sherbehet nepermjet nje rampe per ne katin e nendheshem dhe 3 nyje shkalle ashensore per katin e pare dhe te dyte administrative. Shkallet jane te vendosura me distanca qe respektojne kushtet e evakuimit ne raste zjarri dhe do te sherbejne edhe si shkalle emergjence. Godina do te kete rruge sherbimi ne te gjitha krahët , rruga kryesore ne anen veriore perballe sheshit qendror dhe rruge sherbimi pergjate krahut lindor qe lidhet me rrugen egzistuese ne krahun jugor dhe lidhet me rrugen egzistuese ne krahun perendimor ku jane te organizuara dhe parkimi i hapur bashke me lulishten dhe hapsirat e lira per qytetin. Objekti i konceptuar ne forme katrore me katin e pare transparent dhe dy katet e trajtuara me fasade te ajrosur me material terrakote nga pikpamja arkitektonike do te krijoje objekt simbol per te gjithë qytetin. Ndarjet e ambienteve te brendshme do te realizohen me mure kartoxhesi te izoluara me fiber xhami ndersa krahu i koridorit zyrtar do te jene me fasade xhami te temperuar per te krijuar transparence dhe komunikim viziv me pjesen e jashtme te objektit. Tavanet do te realizohen me kartonxhes ku ne te do te kalojne impiantet elektrike te ndricimit dhe do te realizohet i gjithë montimi impianteve te kondicionimi. Fasada e zyrave eshte e tera xham dhe hijezimi do te realizohet nepermjet panelave te aluminit model ‘brisolei’ qe mundeson rritjen e eficences se energjise gjate dimrit dhe veres.



## **SISTEMI I AJRIT TE KONDICIONUAR**

### **1.1 CILESIA DHE QELLIMI I PUNES**

Pershkrimi i meposhtem ka te beje me furnizimin, shperndarjen, testimin, balancimin dhe venjen ne funksionim te ajrit te ngrohje/ftohjes si nje i tere. Kontraktori do te jete pergjegjes per zgjedhjen e pajisjeve te tilla te cilat do te sigurojne performancen sic kerkohet dhe per pozicionimin e tyre ne godine ne hapsira te tilla qe te lejojne mirembajtjen dhe sherbimin e pajisjeve.


Kur ne specifikime nuk permendet nje cilesi e vecante e materialit, do te kerkohet ne kete rast nje artikull standart i aprovuar nga supervizori. Te gjitha pajisjet do te jene te reja dhe do te mbahen "si te reja" deri dorezimin e objektit. Pajisjet e zgjedhura duhet te jene materiale te cilesise se larte, ne projekt dhe prodhim dhe duhet te jene te pershtateshme per tipin e aplikimit dhe duhet te paraqesin nje funksionim te sigurte pa zhurma ose vibracione te papranueshme ne kushtet e punes se vazhduar.

Normat kryesore te Unifikimit qe perdoren jane normat Europiane EN. Ketu me poshte jane listuar normat e perdorura ne kete projekt:

|                 |                                                               |
|-----------------|---------------------------------------------------------------|
| EN 13141-1:2004 | The ventilation of buildings.                                 |
| EN 13465:2004   | The ventilation of buildings, methods of calculation.         |
| EN 13779:2005   | The ventilation of non-residential buildings.                 |
| EN 13141-1:2004 | The ventilation of buildings-internal and external diffusers. |

## 1.2PERSHKRIMI I IMPJANTIT TE AJRIT TE KONDICIONUAR(NGROHJE/FTOHJES)


Te gjithë ambjentet e godines e te dy kateve te objektit zyra do te sherbehen nga nje impjant i ajrit te kondicionuar te tipit VRF (Variable Refrigeration Flow), duke perdorur si fluid ftohes te tipit R410a.



Skema e kondicionimit *kati perdhe*


## Skema e kondicionimit kati I pare

Pajisjet e jashtme te impjanteve VRF do te jene te tipit monoblok dhe do te perfshijne te pakten nje kompresor Scroll te tipit Linear Inverter me bande te ndryshimit te frekuences (30Hz - 115Hz), duke mundesuar ne kete menyre rregullimin e shpejtesise dhe sasise se fluidit ne perputhje me kerkesat per ngrohje/ftohje. Ato do te vendosen ne tarracen e objektit.



## Skema e kondicionimit kati i dyte

Njesite e brendeshme jane projektuar te tipit vertikale ne dysheme. Ato do te lidhen me njesite e jashtme nepermjet dy linjave tubacionesh bakri si dhe elementet shperndares te tipit kolektore shperndares si dhe "branching header" te parapergatitur ne fabrike. Kushtet e punes se cdo njesie te brendshme do te zgjidhen individualisht nga cdo perdorues dhe do te suprvizohen nga nje system qendror kontrolli.




### 1.3 SPECIFIKIME TEKNIKE

#### 1.3.1 Pajisjet e ajritte kondicionuar

##### 1.3.1.1 Njesit e jashtme te impjantit VRF

SKEMA E LIDHJES SE POMPES SE NXEHTESISE



Njesite e jashtme te impjantit VRF do te jene te tipit monoblok, te paramontuara ne fabrike dhe te gateshme per lidhjen me rrjetin e tubacioneve.

Konstruksioni i tyre do te jete prej llmarine celiku te galvanizuar, te lyer me rezine te pjekur, per garantimin e nje rezistence te mire UV.

Ato duhet te garantojne funksionimin ne ngrohje ne kushte te temperatures se jashtme deri  $-10^{\circ}\text{C}$  (wet bulb) dhe ne ftohje deri ne temperatura te jashtme  $+43^{\circ}\text{C}$  (dry bulb).

Pajisjet e jashtme duhet te perfshijne nje ose disa kompresore Scroll te tipit high-pressure spiral, nje ose disa kembyes ajri te pajisur me qark sub-cooling, valvolat elektronike te

zgjerimit te mbrojtura ne te dy anet me dy filtra, nje valvol 4 rrugeshe, rezervuarin e likuidit dhe nje set valvolash manually- operated ne hyrje te tubacioneve, etj.

Lubrifikimi duhet te kryhet si rezultat i differences ndermjet presioneve ne hyrje dhe dalje, pa qene nevoja e perdorimit te nje pompe.

Te gjithë kompresoret duhet te jene te montuar ne mbeshtetese anti-vibrante. Ato do te jene te parangarkuara si me polivinil edhe me vaj, te jene elektrikisht te mbrojtura me kontrollin e fazeve, sensor te presionit HP, rele, sensor te temperatures se jashtme, etj. Modulet e rregullatoreve elektronike elektronike te integruar ne keto njesi duhet te sigurojne nje kontroll linear te vazhduar te kompresoreve dhe shpejtesise se ventilatoreve te jashtem.

Ventilatorët do te jene te tipit helikoidal dhe do te largojne ajrin vertikalisht. Cdo modul do te kete:

- nje motor DC, vazhdikisht te lubrifikuar dhe te mbrojtur nga infiltrimet e ujit;
- ventilator me eficence te larte, dinamikisht te balancuar.

Nje nderfaqe me perdoruesin (e pozicionuar ne brendesi te ambjenteve qe do te kondicionohen) duhet te siguroje leximin e te gjitha parametrave te punes dhe te sigurise. Vlerat kryesore qe duhet te lexohen do te jene:

- presionet dhe temperaturat e punes: HP dhe LP;
- % e hapjes se cdo valvole elektronike te zgjerimit;
- frekuenca e punes e cdo kompresori;
- koha e punes e cdo kompresori


#### *1.3.1.2 Njesite e brendeshme VRF*

Njesite e brendeshme do te jene te tipit vertikale ne dysHEME dhe do te instalohen ne brendesi te ambjenteve qe do te kondicionohen; trupi i njesise do te jete prej polystireni.

Cdo njesi e brendeshme do te jete e pajisur me elementet e meposhtem: nje kembyes nxehtesie me shume kalime, nje valvol elektronike zgjerimi me diapazon te rregullueshem te mbrojtur nga dy filtra, nje ventilator i brendshem i afte te realizoje te pakten 4 shpejtesi pune, dy sensore te kontrollit te fluidit (likuid dhe gaz), dy sensore ajri (dergim dhe rriqarkullim), nje filter lehtesisht i heqshem, i larshem per ajer te kondicionuar.



## FAN-KOIL ME KASETE ME 4 RRUGE TEKE DHE DOPIE



### 1.3.1.3 Qarqet ftohes

Lidhja ndermjet njesive te brendeshme dhe te jashtme do te behet me tubacione cilesore bakri, me trashesi muri te pershtatshem per perdorim per fludin R410a. Ato do te montohen ne vije te drejte, me mbeshtetese cdo 5m (maksimumi), ne brendesi te tavanit te varur. Rruge kalimet e tubacioneve do te optimizohen per zvoglimin ne maksimum te humbjeve gjatesore.

Te gjitha saldimet do te behen me rryme nitrogjeni dhe nje kujdes i vecante duhet t'i kushtohet

eliminimit te rrezikut te mbetjes se papastertive apo lageshtise ne brendesi te tubacioneve.

Te gjitha devijimet do te behen me elemente te gatshem te tipit “multikit ose header“, horizontalisht ose vertikalisht dhe gjithnje ne perputhje me rekomandimet e manualit te instalimit te prodhuesit.

Cdo tubacion do te termoizolohet vecmas, me veshje materiali termoizolues M0 ose M1, me trashesi minimale 9 mm per linjen leng dhe 13 mm per linjen gaz.

#### *1.3.1.4 Qarqe telektrike*

Cdo njesi e jashtme do te jete pajisur me panelin 400V/3/50Hz+neutri+tokezimi me mbrojtje ne hyrje te linjes dhe nderpreres qarku te tipit D.

Cdo njesi e brendeshme do te furnizohet nga paneli 220-240V/1/50Hz+Neutri+tokezimi me mbrojtje ne hyrje te linjes dhe nderpreres qarku te tipit C.

Nje lidhje e tipit bus do te mundesoje komunikimin ndermjet njesive te jashtme dhe te gjitha njesive te brendeshme. Bus-i do te perfshije 2 percjelles me nje seksion terthor minimal 0.75mm<sup>2</sup>, te papolarizuar dhe te sekermuar.

Kur disa njesi te brendeshme do te instalohen nje te njejtin ambient , ato do te lidhen se bashku me nje bus te tipit H-LINK, duke kufizuar rezikun e gabimeve ne lidhje. Rrjeti i komunikimit duhet te jete i afte per te lidhur se bashku te gjitha njesite e brendeshme dhe te jashtme.

#### *1.3.1.5 Rregullimi*

Njesite e brendeshme do te komandohen nga kontroloire ne distance te tipit REMOTE CONTROL.

Cdo kontrollor duhet te komandoje dhe kontrolloje individualisht dhe njekohesisht te gjitha njesite e brendeshme nepermjet nje display “liquid crystal” dhe do te mundesoje perdoruesin te zgjedhe dhe te shohe parametrat e meposhtem:


- ndezjen dhe fikjen e pajisjes;
- temepraturen e kerkuar (ne diapazonin 17°C/30°C);
- temperaturen e ambjentit;
- shpejtesine e ventilatorit (Hi/Me/Lo).

Kontrollori ne distance duhet te beje te mundur zgjedhjen e menyres se operimit (5 menyra ndermjet te cilave edhe ngrohje/ftohje automatike), komandimin e kontrollit javor, mbrojtje kunder ngrirjes, etj.

Nepermjet nje programimi te thjeshte, kontrolli ne distance duhet te mundesoje ndermjet te tjerash mundesine e vrojtimit te parametrave te punes (temepraturen e kerkuar, menyren e operimit, shpejtesine e ventilatorit dhe te gjithe funksionet dhe parametrat e tjera te nevojshem per mirembajtjen (kodet e gabimeve, autodiagnostiken, etj.)



# RELACION I PROJEKTIT HIDROSANITAR



**PROJEKT ZBATIMI :**  
***“NDERTIMI I GODINES SE BASHKISE DIVJAKE”***

**INVESTITORI:**  
***FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT***

**VENDNDODHJA:**  
***QYTETI DIVJAKË, BASHKIA DIVJAKË***

**PROJEKTUES:**  
***CEC GROUP sh.p.k***


***Tirane 2020***

## **Planimetria e vendndodhjes së projektit**

Objekti i ri i bashkise eshte i konceptuar si objekti i ndertuar ne dy trupa te organizuar ne forme katrore me dimensione te jashtme 45m me drejtimin Lindje –Perendim dhe 34.1 m ne drejtimin Veri-Jug. Do te kete 4 kate nga te cilet 1 eshte i ndertuar nentoke me funksion parkim per administraten dhe publik. Ne katin perdhe do te organizohen sherbimet dhe kontakti me qytetaret nderta dy katet e sipërme do te jene ne funksion te administrates dhe keshillit bashkia. Nderthurja e ketyre dy trupave krijone nje hapsire te lire te perbashket ne qender me dimensione 27.5 m me 21.1 m dhe sipërfaqe 577.5 m<sup>2</sup> qe do te perdoret si hapsire qe do te shfrytezohet nga administrata dhe qyteti ne raste evenimentes. Objekti sherbehet nepermjet nje rampe per ne katin e nendheshem dhe 3 nyje shkalle ashensore per katin e pare dhe te dyte administrative. Shkallet jane te vendosura me distanca qe respektojne kushtet e evakuimit ne raste zjarri dhe do te sherbejne edhe si shkalle emergjence. Godina do te kete rruge sherbimi ne te gjitha krahët , rruga kryesore ne anen veriore perballe sheshit qendror dhe rruge sherbimi pergjate krahut lindor qe lidhet me rrugen egzistuese ne krahun jugor dhe lidhet me rrugen egzistuese ne krahun perendimor ku jane te organizuara dhe parkimi i hapur bashke me lulishten dhe hapsirat e lira per qytetin. Objekti i konceptuar ne forme katrore me katin e pare transparent dhe dy katet e trajtuara me fasade te ajrosur me material terrakote nga pikpamja arkitektonike do te krijoje objekt simbol per te gjithë qytetin. Ndarjet e ambienteve te brendshme do te realizohen me mure kartoxhesi te izoluara me fiber xhami ndersa krahut i koridorit zyrtar do te jene me fasade xhami te temperuar per te krijuar transparence dhe komunikim viziv me pjesen e jashtme te objektit. Tavanet do te realizohen me kartonxhes ku ne te do te kalojne impiantet elektrike te ndricimit dhe kondicionimi. Fasada e zyrave eshte e tera xham dhe hijezimi do te realizojet nepermjet panelave te aluminit model ‘brisolei’. Objekti nuk do te sherbeje vetem si ambiente per dhenien e sherbimit por edhe si vlere e shtuar per paisazhin dhe sheshit qendror dhe te qytetit ne teresi.



Jug



Lindje

Perendim

Veri

### PER FURNIZIMIN ME UJE

Eshte trajtuar per sigurimin e sasise se ujit duke gjykuar se sasia e nevojshme do te mundet te sigurohet nga burime alternative (pus shpim). Prurja llogaritese dhe shperndarese u mbeshetet ne normat teknike per furnizimin me uje te njesive familjare me lavanteri dhe dushe ne godine dhe normave te perdorimit. Dimensionimi dhe projektimi i te gjithe komponenteve dhe aksesoreve te sistemit te furnizimit dhe te shperndarjes te ujit te ftohte dhe te ngrohte sanitar eshte realizuar duke marre ne konsiderate elementet e meposhtem:

- Skema e shperndarjes;
- Dimensionimi i rezervuarve te ujit per 8 ore autonomi;
- Percaktimi i prurjes nominale per cdo aparat h/sanitar dhe dimensionimi i tubove.
- Dimensionimi i tubacioneve magjistrale dhe ato te riqarkullimit;



- Prurja totale nominale;
- Prurja projektuese;
- Presioni i punes;
- Humbjet gjatesore njesi te presionit;
- Shpejtesia max. e qarkullimit te ujit;
- Dimensionimi i stacionit te pompimit (shpejtesi konstante)

Duke qene se nga investitori dhe ndermarrja e ujsjelles kanalizime nuk eshte dhene aftesia dhe mundesia maksimale per furnizim me uje ne piken e lidhjes,atehere jemi te detyruar qe te llogarisim dhe rezerven per uje ,e cila perbehet :

1-Nga volumi i nevojshem ditor per konsum gjate 24 oreve

2-Rezerven ne rast avarie per 8 ore

3-Rezerven per te perballuar zjarre te mundshme

Per te perballuar nevojat e konsumit ne ore te ndryshme te dites i pavarur nga sistemi i ujsjellesit, per te mos e mbidimensionuar rrejtin furnizues, per te perballuar sasine maksimale te ujit eshte e nevojshme te ndertohet "depo"uji me vellimin e nevojshem e cila do te rezervonte sasine e tepert qe vjen nga rrjeti ne oret me konsum minimal per ti perdorur ne oret e pikut.

Kjo "depo"uji vec kesaj do te ruaj sasine e nevojshme per raste avarie ,si dhe per raste te renies se zjarrit.

Vellimi rregullues i depos dote krijoje mundesi te sigurimit ne cdo ore te sasive maksimale ,do te ulte ose zvogelonte diametrat e linjave te furnizimit nga jashte.

Vellimi i depove ben te mundur qe objekti te kete furnizim te panderprere ne raste avarije dhe remonte te ujsjellesit nga furnizohet.

### **Stacioni i pompave te ujit**

Stacioni i pompes se ujit eshte pjesa me rendesishme e sistemit. Ai eshte parashikuar te funksionoj me pompa dhe rezervuare parametrat e te cileve jane llogaritur ne perputhje me diagramat ditore te nevojave per uje dhe konfiguracionit te rrjetit.

Ne funksion te tyre jane llogaritur presioni, prurja, fuqia e pompave si dhe specifikime teknike te tjera. Sistemi eshte projektuar duke parashikuar nje stacione pompimi, i cilat duhet te instalohen ne perputhje me kerkesat e projektit.

Stacioni eshte parashikuar qe te siguroje nje sasi uji qe perafersisht te mbuloje 48 ore autonomi dhe qe do te depozitohet ne rezervuaret e kalkuluar per kete qellim.

Stacioni eshte parashikuar qe te furnizoj me uje te pijshem stallen dhe uje sanitar te gjitha pajisjet h/sanitare qe jane instaluar per cdo nyje sanitare dhe per cdo ambient teknik. Pajisjet e ketij stacioni jane instaluar ne ambientet e percaktuar ne projekt.

Ky stacion eshte kompozuar me 2 pompa uji ne versionin e pompave centrifugale me shume shkalle vertikale. Keto pompa jane vendosur ne nje bazament me konstruksion llamarine celiku te galvanizuar e mbeshtetur ne suportet celiku me gome antivibrante per te eliminuar vibrimet dhe zhurmat gjate pune se pompave. Suportet metalike nuk jane te lidhura me bazamentin ose muret e ndertesës.

Pompat jane pajisur me kolektoret e thithjes dhe dergimit qe jane te galvanizuar me





Ato kane ne perberje gjithashtu flusometer, manometer, valvola nderprerse, moskthimi si dhe panel elektrik komandimi dhe kontrolli, si dhe presostate te taruar paraprakisht.

Grupi i pompave te ujit sanitar ne perberje te stacionit automatik pervec anes mekanike te pershkruar me siper ka ne perberje panelin elektrik, presostat te presionit te ulet dhe te larte, galexhant elektrik, kuader elektrik per leshimin edhe mbrojtjen. Ai ka ne perberje rregullatorin elektronik per funksionimin ne menyre te shkallezuar te pompave (temporizator), si dhe per mbrojtjen dhe sinjalizimin e mbi/nen tensioneve, si dhe ne rastet e ndrim i mungese faze ne qarkun elektrik. Grupi eshte i pajisur me valvolsigurie 10 bar. Ai duhet te vendoset ne menyre

te tille qe te siguroje para dhe anash hapsiren e nevojshme per per operacione prove dhe mirembajtje. Per te evituar rezonancat ose tensionet mekanike per jashtequndersine, duhet te instalohen suporte mbeshtetes. Rekomandohet te vendosen suporte mbeshtetes edhe tek tubot e kolektoreve te dergimit dhe te kthimit. Bazamenti duhet te jete prej betoni dhe mberthimi duhet te kryhet me amortizator. Cdo pompe eshte e kontrolluar nga nje kuader elektrik indipendent, me lexim te lehte te instrumentave te matjes dhe sinjalizimit.

### **Uji i ngrohte sanitar**

Uji i ngrohte sanitar eshte i kompozuar te realizohet prej prodhuesit te energjise termike qe ne rastin tone do te jene boilerat elektrike si dhe tubacioneve e pajisjeve te tjera per furnizimin dhe rregullimin tij. Kjo ne funksion te deshires se pronarit.

Prodhuesi i ujit te ngrohte sanitar eshte perzgjedhur per te siguruar furnizim gjate gjithe dites. Madhesia e tij eshte kalkuluar ne funksion te nevojave per uje sanitar dhe karakteristikat e tij duhet te jene percaktuar qarte ne certifikaten e kualitetit leshuar nga prodhuesi. Karakteristikat teknike kryesore jane praqitur ketu me poshte:

Tipi : Boiler vertikal ose horizontal i termoizoluar me shkembyes inoksi te cmontueshem;

Izolimi : Shtrese fleksibile shkume poluretane 50 mm trashesi;

Veshja e jashtme : Celiku me karbon, i mbrojtur me nje shtrese epoksidi ne ngjyre te bardhe e polimerizuar;

Mbrojtja : Sistemi i mbrojtjes katodike, anode magneze e thjeshte;

Kapaciteti : 10-30 lit; tip Lili put vendoset nen lavamane

Kondita e punes:  $P_{max}$  8 bar,  $T_{max}$  95 °C.

### **Sistemi i shperndarjes te ujit sanitar**

Sistemi i shperndarjes i ujit sanitar do te sherbeje per te siguruar ujin e ftohte dhe te ngrohte nga stacioni i pompimit tek kolektorët dhe mbas kesaj te siguroje shperndarjen e ujit ne pajisjet e ambienteve sanitare. Sistemi i tubove te ujit sanitar dote plotesoje kerkesat e normave dhe standarteve te percaktuar dhe seleksionuar qysh ne fazen e projektimit prej stafit inxhinierik si dhe te kerkesave paraprake te investitorit. Tubo e ketij sistemi jane ndare ne funksion te materialit te tyre si me poshte:

- Tubo PEHD - (Polyetilen i densitetit te larte) per rrjetin e jashtem
- Tubo celiku te zinkuar pa tegel per kolonat
- Tubo PE-Xa - (Polyetilen i retuikulluar) per shperndarjes ne kate

- Tubat e celiku te zinkuar pa tegel do te perdoren ne furnizimin e ujit nga pompat, rezervuaret



- Tubat plastike (PE-Xa) janë rezistent kundër korrozionit. Ata duhet të vendosen në vende, ku materialet e lartpërmendura nuk mund të vendosen për shkak të korrozionit dhe agresivitetit të ujit. Në rastin konkret ato janë përdorur në dysheme të tilla si gjatë ambienteve. Duhet kujdesur që tubat plastike, të plotësojnë kërkesat e shtypjes dhe temperaturës së nevojshme.

Tubo Polyetileni (PE-Xa) të retikuluar janë përzgjedhur në përputhje me standarte internacionale të kualitetit ISO 9001 ose DIN 53457. Këto tuba janë vendosur në dysheme të tilla si nyjeve sanitare dhe kanë veti të shkelqyera si dhe kundër agjentëve kimikë, stabilitet të lartë termik, peshë të ulët, humbje të ulta presioni, të thjeshtë në mirëmbajtje për riparime dhe transport, të thjeshtë në instalim dhe një jetëgjatësi prej mbi 50 vjet.

Vetite termofizike të tubave PE-Xa janë me poshtë si vijon:

- Densiteti 0,93 g /cm<sup>3</sup>
- Temperatura deri në 110 gradë Celsius
- Përcjellshmëria termike 23 W/mK
- Koeficienti i zgjerimit termik linear 1,4 x 10<sup>-5</sup> K<sup>-1</sup>
- Moduli i elasticitetit në 20 gradë 670 N/mm<sup>2</sup>
- Ashpërsia e tubit 0.007 mm

Ndërthurja e dy trupave krijon në qendër një atrium, pra një hapësirë të lirë të përbashkët qendrore me dimensione 27.5 m me 21.1 m dhe sipërfaqe 577.5 m<sup>2</sup>do të përdoret si hapësirë që do të shfrytëzohet për administratën dhe banorët në rast organizimi evenimentesh .

Hyrja për në objekt do të realizohet nëpërmjet një rampe përnjë kati nëntoke dhe 3 nje shkallë ashensor për katin e parë dhe të dytë të administratës. Shkallët janë të vendosura me distanca që respektojnë kushtet e evakuimit në rast zjarri dhe do të shërbejnë edhe si shkallë emergjence. Godina do të jetë e aksesueshme me rrugë shërbimi në të gjitha anët. Rruga kryesore në anën veriore përballë sheshit qendror dhe rrugë shërbimi përgjatë anës lindor që lidhet me rrugën ekzistuese në anën jugor, gjithashtu lidhet edhe me rrugën ekzistuese në anën perendimor ku janë të organizuar parkimi i hapur bashkë me lulishten dhe hapësirat e lira për banorët.



## Planvedosja e strukture

Objekti i konceptuar në formëkatrore, në katin perdhe transparent dhe dy katet e tjera te trajtuara me fasade të ajrosur pjeserisht dhe pjeserisht me material terrakote krijojne nga pikpamja arkitektonike objektin simbol per te gjithë qytetin. Ndarjet e ambienteve të brendshme do të realizohen me mure kartoxhesi të izoluara me fiber xhami ndërsa ana nga korridori ku jane pozicionuar zyrat do të jenë me fasade xhami të temperuar për të krijuar transparence dhe komunikim viziv me pjesën e jashtme të objektit. Tavanetdo të realizohen me kartonxhes ku në të do të kalojnë impiantet elektrike të ndriçimit dhe kondicionimi.Fasada e zyrave është e gjitha me xham dhe hijezimi do të realizohet nëpërmjet panelave të aluminit model ‘brisolei’. Objekti nuk do të shërbejëvetëm si godinë në funksion të shërbimeve por dhe si njëvlerë e shtuar për peisazhin e sheshit qëndror dhe të qytetit në tërësi.




### 1.3.4 Kati nentoke

Sipërfaqja e katit nëntokështë 1151.16 m<sup>2</sup> me 28 vende parkimi. Në të janë pozicionuar dhe aksesit për personat me aftësi të kufizuar qëshërbehet nga 1 rampe dhe dy shkallët në fasadën veriore. Gjithashtu në anën jug-lindor do të jetë një magazinë dhe ambienti teknik ku do të sisemohen matesit dhe komandimi i sistemeve të objektit.

Lartësia e katit është 3.2 m dhe qendra është e rrethuar me mure betoni me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>. I gjithë kati do të jetë i pajisur me të gjitha sistemet si ndricim, alarm zjarri, sinjalistike, etj.






### 1.3.5 Kati perdhe

Kati përdhe është organizuar si hapësirë për takime me publikun, marrje dhe dhënie e informacionit nëpërmjet shërbimeve që kanë lidhje me qytetarët. Hapësirat janë të rrethuara me fasade xhami në mënyrë që të lejojnë transparence me katin përdhe dhe për të krijuar vazhdimësi të sheshit qendror.

Hyrja kryesore e godinës është në anën Veriore ku do të mund të aksesohet nëpërmjet dy grupevetë shkallës dhe ashensorëve. Shkallët në Veri Lindje komunikojnë deri në katin e parë të zyrave ku dhe do të përdoren nga kryetari. Grupi i shkallës dhe ashensorit në Veri-Perëndim do të përdoret nga Këshilli Bashkiak për në katin e parë dhe zyrat e administratës në anën perëndimor të godinës dhe me katin e dytë të zyrave.

Në katin përdhe me sipërfaqe 506.34 m<sup>2</sup> janë të organizuara :

3 njet e lëvizjes vertikale për në objekt, 2 njet higjieno sanitare , Zyra e one-stop shopit, ambjente pritje dhe ekspozitive në hollin e hyrjes kryesore , kujdesi ndaj klientit OSHEE, një ambient bar kafe dhe shërbime për administratën .




### 1.3.6 Kati i pare

Në katin e parë janë të organizura sipas anevë 3 nyje shkalle/ashensor sëbashku me nyjet higjienosanitare që shërbejnë të gjithë godinën. Në fasadën Veriore janë pozicionuar ambientet e kryetarit , salla e këshillit bashkiak dhe 2 ambiente për sekretaret e keshillit, kryetarit të bashkisë sëbashku me ambientin e sekretarisë. Në anën perëndimor janë të pozicionuara shërbimi social dhe burimet njerëzore sëbashku me arkiven ne këndin jug-perendimor. Nëanën jugor janë të pozicinouara ambientet e zyrave juridike dhe zyrat arsimore. Ne anën lindor zyrat e financës. Kati i pare ka nje siperfaqe 929.24 m<sup>2</sup> dhe ka 2 nyje higjienosanitare për administratën dhe këshillin bashkiak dhe 1 nyje për ambientet e kryetarit .


Objekti është projektuar për të mos pasur qarkullim në katin e parë për administratën. Lidhja e së cilës do të realizohet vetëm në katin e dytë administativ.





### 1.3.7 Kati i dyte

Kati i dytë administrative ka një sipërfaqe 919.13 m<sup>2</sup> dhe është i shërbyer nga 2 korpuse shkalle dhe ashensore, dhe i gjithë objekti është i lidhur me korridor perimetral. Janë të organizuara në anën verior zyrat e kadastres dhe urbanistikës, në anën lindor ndërmarja komunale , sh.a ujësjellësi , në anën jugor janë të organizuara zyra mjedisit dhe nënkryetari. Në anën perëndimor në këtë kat, pra Kati i dytë, ka dy njëje higjienosanitare ngjitur me grupin e shkalleve



1 KATI II MOBILIMI  
1 : 200

Tabela me të dhënat e përgjithshme për cdo kat

| Nr. KATIT                       | FUNKSIONET             | SIPERFAQJA (m <sup>2</sup> ) |
|---------------------------------|------------------------|------------------------------|
| Kati Nentoke                    | Magazine               | 34.71                        |
| Kati Nentoke                    | Parkim                 | 1116.45                      |
| Kati Nentoke - Siperfaqja Total |                        | 1151.16                      |
|                                 |                        |                              |
| Kati Perdhe                     | One stop shop          | 80.01                        |
| Kati Perdhe                     | NHS                    | 9.26                         |
| Kati Perdhe                     | NHS                    | 5.45                         |
| Kati Perdhe                     | Holli                  | 154.67                       |
| Kati Perdhe                     | Bar, Kafe              | 78.76                        |
| Kati Perdhe                     | NHS                    | 4.93                         |
| Kati Perdhe                     | Kendi BE / Zyrat OSHEE | 96.53                        |
| Kati Perdhe                     | NHS                    | 8.88                         |
| Kati Perdhe                     | Korridor               | 25.91                        |
| Kati Perdhe                     | NHS                    | 5.80                         |
| Kati Perdhe                     | NHS                    | 5.24                         |
| Kati Perdhe                     | Korridor               | 22.31                        |
| Kati Perdhe                     | Korridor               | 8.56                         |
| Kati Perdhe – Siperfaqja Totale |                        | 506.34                       |
|                                 |                        |                              |
| Kati i Pare                     | Sherbimi social        | 17.40                        |
| Kati i Pare                     | NHS                    | 4.67                         |
| Kati i Pare                     | NHS                    | 4.40                         |



|                                 |                   |        |
|---------------------------------|-------------------|--------|
| Kati i Pare                     | Sekretar Keshilli | 17.85  |
| Kati i Pare                     | Sekretari         | 20.37  |
| Kati i Pare                     | Sekretar Keshilli | 17.30  |
| Kati i Pare                     | Burimet njerezore | 17.59  |
| Kati i Pare                     | Burimet njerezore | 17.26  |
| Kati i Pare                     | NHS               | 9.04   |
| Kati i Pare                     | NHS               | 2.65   |
| Kati i Pare                     | NHS               | 2.63   |
| Kati i Pare                     | NHS               | 6.80   |
| Kati i Pare                     | Financa           | 46.84  |
| Kati i Pare                     | NHS               | 4.34   |
| Kati i Pare                     | NHS               | 9.23   |
| Kati i Pare                     | Zyra arsimore     | 17.47  |
| Kati i Pare                     | Zyra arsimore     | 17.33  |
| Kati i Pare                     | Zyra juridike     | 17.33  |
| Kati i Pare                     | Zyra juridike     | 17.17  |
| Kati i Pare                     | Zyra juridike     | 17.80  |
| Kati i Pare                     | NHS               | 4.96   |
| Kati i Pare                     | Arkiva            | 67.47  |
| Kati i Pare                     | Sherbimi social   | 16.24  |
| Kati i Pare                     | Salla e keshillit | 94.92  |
| Kati i Pare                     | Zyra e Kryetarit  | 48.27  |
| Kati i Pare                     | Korridor          | 52.53  |
| Kati i Pare                     | Financa           | 34.52  |
| Kati i Pare                     | Financa           | 17.21  |
| Kati i Pare                     | Financa           | 15.78  |
| Kati i Pare                     | Korridor          | 126.82 |
| Kati i Pare                     | Zyre Arsimore     | 18.22  |
| Kati i Pare                     | Burime njerezore  | 16.25  |
| Kati i Pare                     | Sherbim social    | 17.49  |
| Kati i Pare                     | Korridor          | 113.11 |
| Kati i Pare - Siperfaqja Totale |                   | 929.24 |
|                                 |                   |        |
| Kati i Dyte                     | NHS               | 9.72   |
| Kati i Dyte                     | N/ Komunale       | 17.18  |
| Kati i Dyte                     | NHS               | 5.22   |
| Kati i Dyte                     | Urbanistika       | 16.68  |
| Kati i Dyte                     | Urbanistika       | 17.46  |
| Kati i Dyte                     | Urbanistika       | 34.34  |
| Kati i Dyte                     | Zyre Kadastra     | 17.74  |
| Kati i Dyte                     | Zyre Kadastra     | 17.77  |
| Kati i Dyte                     | Zyre Kadastra     | 17.25  |
| Kati i Dyte                     | Zyre Kadastra     | 31.02  |
| Kati i Dyte                     | NHS               | 5.18   |
| Kati i Dyte                     | NHS               | 12.20  |
| Kati i Dyte                     | NHS               | 5.54   |
| Kati i Dyte                     | NHS               | 4.41   |
| Kati i Dyte                     | Zyre Arkiva       | 34.19  |
| Kati i Dyte                     | N/ Komunale       | 16.58  |
| Kati i Dyte                     | Zyra Ujesjellesi  | 17.51  |
| Kati i Dyte                     | Zyra Ujesjellesi  | 16.39  |
| Kati i Dyte                     | Zyra Mjedisi      | 17.44  |



|                                       |                                   |                |
|---------------------------------------|-----------------------------------|----------------|
| Kati i Dyte                           | Zyra Mjedisi                      | 17.22          |
| Kati i Dyte                           | Zyra Mjedisi                      | 17.55          |
| Kati i Dyte                           | Zyra e Sekretarit te Pergjithshem | 17.90          |
| Kati i Dyte                           | Zyra e Nenkryetar                 | 17.93          |
| Kati i Dyte                           | Zyra e Nenkryetar                 | 18.53          |
| Kati i Dyte                           | NHS                               | 4.60           |
| Kati i Dyte                           | NHS                               | 4.03           |
| Kati i Dyte                           | Zyra Ujesjellesi                  | 16.33          |
| Kati i Dyte                           | N / Komunale                      | 17.06          |
| Kati i Dyte                           | Zyra Mjedisi                      | 15.66          |
| Kati i Dyte                           | Zyra Mjedisi                      | 17.58          |
| Kati i Dyte                           | Zyra Mjedisi                      | 17.63          |
| Kati i Dyte                           | Dhoma Sanitare                    | 17.63          |
| Kati i Dyte                           | Dhoma Sanitare                    | 17.29          |
| Kati i Dyte                           | Zyra Mjedisi                      | 16.63          |
| Kati i Dyte                           | Zyra Urbanistika                  | 17.91          |
| Kati i Dyte                           | Korridor                          | 207.19         |
| Kati i Dyte                           | Korridor                          | 138.19         |
| Kati i Dyte                           | NHS                               | 8.33           |
| Kati i Dyte - Siperfaqja Total        |                                   | 919.13         |
|                                       |                                   |                |
| <b>SIPERFAQJA E TE GJITHE GODINES</b> |                                   | <b>3505.87</b> |

### 1.3.8 Teknologjia e ndërtimit.

Nga ana teknologjike është kushtuar vëmendje e vecantë për hidro dhe termoizolimin e objektit . Muri perimetral do të realizohet me tullë bllok 25 cm dhe termoizolimi do të realizohet me fasaden e ajrosur qe do të realizohet në terrakote me panele fiber xhami.



Shembull ilustrativ

Ndërsa fasada e brendshme do të realizohet me xham struktural termik e hijezuar me elementin e brisolei alumini vertikal.



Shembull ilustrativ

Muret e brendshme do të realizohen me kartonxhes dhe panele fiber xhami për izolimin akustik.

## 1.4 Informacion i përgjithshëm në lidhje me zonën ku është propozuar projekt

### 1.4.1 Gjeografia

Koordinatat gjeografike te Divjakës janë: gjatësia 3 km dhe gjerësia 1 km. Lartësia mbi nivelin e detit varion nga 3m deri ne 5m. Largësia nga rruga lokale deri ne rrugënnacionale është rreth 16 km. Për tu ardhur ne ndihme banoreve qe te udhëtojnë ne vende te ndryshme ne Divjakë ndodhet një stacion autobusësh qe plotëson nevojat e qytetareve

Bashkia e re Divjakë kufizohet në veri me bashkinë Rrogozhinë, në lindje me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik.

Bashkia e re ka një shtrirje veri-jug ndërkohë që rrugët janë më së shumti në drejtimin lindje-perëndim dhe lidhja rrugore mes qytetit të Divjakës dhe komunave Gradishtë e Rremas është e dobët.



Fig. 1 Harta e re territoriale e Bashkisë Divjakë

### 1.4.2 Gjeomorfologjia

Me poshte japim nje pershkrim te depozitimeve qe takojme ne zonen tone ne studim :

a) *Depozitimet aluviale* kane perhapje te gjere ne zonat e ulta, ne rrjedhjet e mesme te lumenjeve, shpesh edhe ne rrjedhjet e sipërme. Ne rrjedhjet e mesme dhe te sipërme ato formojne depozitimet e teracave te shtratit si dhe depozitimet e sotme te shtratit, te cilat i perkasin

b) *Depozitimet proluviale* perhapen gjeresisht si ne zonat e ulta ashtu dhe ne zonat e larta, pergjithesisht perfaqesojne depozitimet e formuara nga perrenje qe derdhen ne luginat e lumenjve kryesore, te perrenjeve qe pershkojne zonat fushore dhe ato bregdetare

c) *Depozitimet, deluviale dhe koluviale* .Ne Harten gjeologjike te shkalles 1 :200 000 kryesisht jane dalluar formimet koluviale, te cilat ne mjaft raste i perkasin nje diapazoni me te



gjere (se paku nga Pleistoceni i vonshem deri me sot). Ato i takojme pothuaj ne te gjitha kembet e shpateve te kodrave dhe maleve, sidomos ne ato qe perbehen nga terigjene dhe flishore (relativisht te pa qendrueshem ndaj agjenteve atmosferike).

d) *Depozitimet kenetore dhe liqenore-kenetore* Depozitimet kenetore dhe ato liqenore e liqenoro-kenetore kane perhapje te gjere pergjate Ultesires Adriatike dhe ne zonat fushore te gropave te brendeshme. Nga me tipiket do te permendnim depozitimet kenetore te Maliqit, ne Cuke te Sarandes, ne Domosdove, ne Bytyç, ne luginen e Vajkalit, etj ; si dhe ato te Ultesires Adriatike, duke filluar nga ato liqenore ne zonen e Koplikut, ne Kakariq te Lezhes, ne Thumane, ne Terbuf e Karavasta te Lushnjes, ne Mbrostar e Seman te Fierit, ne Narte, etj.

e) *Depozitimet lagunore* .Ne zonen litorale te detit Adriatik jane te perhapura depozitimet lagunore, qe jane depozitime ndermjet atyre kontinentale dhe detare. Ato takohen prane deltave te lumenjeve kryesore te vendit tone. Keshtu nga veriu ne jug ne takojme depozitimet lagunore te Velipojes, depozitimet lagunore te Lezhe-Milotit, ne Durres, Divjake, Topoje, Boçove e Narte.

f) *Depozitimet detare* Ne vendin tone kane perhapje pergjate bregdetit Adriatik. Ato dalin ne siperfaqe prane vijes bregdetare deri ne disa qindra metra ne drejtim te kontinentit, pastaj ato shtrihen poshte depozitimeve lagunore, aluviale e kenetore. Ato kane trashesi nga disa metra deri ne 100m ne drejtim te detit. Perfaqesohen kryesisht nga rera te madhesive te ndryshme. Me depozitimet detare jane te lidhura dhe shkrikerimet detare te plazheve te sotme, por edhe ato te mbuluara ne brendesi te kontinentit. Vlen te theksohet qe ne fillimet e Holocenit te vonshem (rreth 5 000 vjet me pare) deti Adriatik kufijte i ka patur me te shtrire.

### 1.4.3 Tokat

Bashkia e re ndodhet në një zonë tërësisht rurale dhe pjellore, ndërkohë që pjesë e territorit të kësaj bashkie është edhe parku kombëtar Divjakë-Karavasta, si dhe plazhi i Divjakës.

Bashkia e re ka aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe në një masë më të vogël peshkimin në lagunën e Karavastasë. Prodhimi kryesor bujqësor janë bostanoret, të cilat shiten në tregun e brendshëm si dhe eksportohen në shumë vende të Europës qendrore dhe lindore.

Divjaka shtrihet ne brendësi te një fushe. Ne territorin e saj ka pasuri nëntokësore siç është gazi natyror. Këto pasuri janë shfrytëzuar nga njerëzit qe prej 30 vjetësh.

Format kryesore te relievit janë :

- kodër - 100 ha
- fushë - 1800 ha                      pyll - 1275 ha

Në hapësirën bregdetare te plazhit te Divjakes llojet e tokave janë përcaktuar për vetë pozici onin gjeografik që ka dhe nga formacionet gjeologjike që e ndërtojnë. Kushtet natyrore për proceset e tokëformimit në këtë hapësirë janë shumë të volitshme (formacione terrigjene e depozi time kuaternare, klimë mesdhetare, reliev fushor dhe kodrinor etj).

Por krahas tyre edhe veprimtaria e njeriut ka qenë faktor me rëndësi në proceset tokëfor muese të kësaj hapësire. Theksojmë këtu punimin intensiv, plehërimin, ujitjen, mbjelljen me kultura, qarkullimin bujqësor etj. Këto procese jo vetëm kanë mënjanuar shkatërrimin e degradimin e tyre por kanë ndikuar edhe në përmirësimin e strukturës dhe cilësisë fiziko-kimike e agrobiologjike të tyre.

Hapësira bregetare në studim mbulohet nga toka të hirta kafe, kafe dhe toka jozonale si; aluvionale, moçalike dhe të kripura. Më të përhapura janë tokat e hirta kafe, të cilat mbulojnë të gjithë territorin

kodrinor. Këto toka janë formuar mbi shkëmbinjtë argjilorë, shtufe ranorë e konglomeratë. Ato kanë përbërje mekanike subargjilore të mesme dhe subargjilore të lehtë, janë pothuajse të shpëlara. Këto toka në përgjithësi janë të pasura në azot dhe të varfëra në fosfor, kanë profil të diferencuar, trashësia e humusit arrin nga 10 cm deri në 50 cm, të pasura në masën 15-18% me karbonat kalciumi.

#### 1.4.4 Kushtet klimatike

Klima është mesdhetare dhe është një klimë jo e shëndetshme sepse ka shumë kontraste midis stineve.

- Temperatura mesatare shumëvjeçare vjetore është 21 °C.
- Temperatura mesatare shumëvjeçare e janarit është 5 °C.
- Temperatura mesatare shumëvjeçare e korrikut është 30 °C.
- Temperatura minimale absolute është -1 °C.
- Temperatura maksimale absolute është + 38 °C.

Reshjet bien kryesisht në stinën e pranverës. Reshjet e dëborës janë të rralla në këtë vend. Reshjet e breshërve bien me shumë në stinën e pranverës. Takohen deri në 3 ditë me breshër në vit. Ngricat janë të rralla. Takohen deri në 10 ditë me ngrica në vit. Ngricat e para shfaqen në muajin janar ndërsa të fundit në muajin mars. Periudha e thatësisë zgjat rreth 90 ditë në vit. Ka pasur raste edhe të thatësirave të tejzgjatura dhe kanë qenë rreth 3 raste në 10 vjet. Era është e shpeshtë. Erërat dominuese të gjysmës së ngrohtë të vitit vijnë nga jugu ndërsa të gjysmës së ftohtë nga veriu. Në Divjakë nuk mungon edhe rasti i stuhive. Ato ndodhin me shpesh në mars dhe numërohen mesatarisht 2 ditë me stuhinë në vit. Demet që kanë sjelle stuhite kanë qenë : rrëzimi i drithërave, rrëzimi i pemëve të vjetra që shpesh herë shkaktonte edhe rrëzimin e linjave elektrike.

#### 1.4.5 Flora dhe Fauna

Zona e parkut kombëtar Divjakë-Karavasta është zona më e rëndësishme komplekse e Shqipërisë për sa i përket biodiversitetit. Kjo zonë strehon përqendrimin më të lartë të shpendëve ujorë rreth 51 000 individë, dhe rreth 500 çifte folenizues në Shqipëri. 89 specie të ndryshme që përfaqësojnë grupet e molusqeve, insekteve, amfibëve, zvarranikëve, zogjve dhe gjitarëve, të pranishme në zonën e parkut, janë konsideruar si të kërcënuara në Shqipëri. 42 specie i përkasin kategorive shumë të rrezikuara, duke përfshirë rrezik kritik, të rrezikuara dhe vulnerable.

Në brendësi të saj ka dhe ishuj të vegjël, në të cilin folenizojnë shpendët. Karakteristike në këtë zonë është kolonia e Pelikanit Kaçurel me rreth 60 çifte që përfaqëson rreth 5% të numrit të përgjithshëm të kësaj specie në shkallë botërore .

Në Lagunën e Karavastasë rriten disa lloje të rralla pishash dhe një lloj i rrallë Pelikani Dalmatian Pelican. Supozohet se 5 % e të gjithë pelikanëve të këtij lloji jetojnë aty. Kara vastaja bën pjesë në parkun kombëtar të Divjakës. Është më e madhja e vendit tonë dhe në gjithë bregdetin jugor të Adriatikut, sip. 4330 ha, gjatësia 10.6 km, gjerësia 4.3 km dhe thellësia deri në 1.5 m.

Ndahet nga deti nëpërmjet një brezi të gjerë rëre, të mbuluar nga pylli i dendur, buzë të cilit ndodhet një plazh mjaft i madh. Lidhet me detin me tri kanale, njëri prej të cilëve artificial, i hapur për nevojat e peshkimit. Nëpër këto kanale, si pasojë e baticës dhe zbatës, rrjedhja e ujit ndryshon drejtim çdo 6 orë.

##### *Bota shtazore*

Bota shtazore tokësore dhe detare e hapësirës bregdetare të parkut kombëtar Divjake - Karavasta ka qenë shumë e pasur në lloje dhe sasi. Aktualisht kemi një varfërim në lloje dhe sasi, rrjedhojë e keq

administrimit të ekonomisë pyjore, gjuetisë pa kriter, ndotjes së lumenjve si dhe ujërave rrjedhëse që derdhen direkt në det. Në ditët e sotme vihet re një përmirësim i ndjeshëm që lidhet me zhvillimet sociale të hapësirës, të përkujdesit dhe zbatimit të ligjit.

*Fauna tokësore:* Në përgjithësi fauna tokësore është e varfër, sidomos në kafshë të mëdha gjitarë, në mungesë të pyjeve të larta, popullimit të dendur të hapësirës dhe dominimit të relievit fushor me toka të kultivuara me bimë arash. Në pakësimin e kafshëve të egra ka ndikuar dhe gjuetia pa kriter e llojeve objekt gjuetie. Theksojmë se janë rralluar kafshë të tilla si lepuri, baldosa dhe shpezë si: thëllëza e fushës, shkurta, pëllumbi i egër etj. Nga llojet më të përhapur të gjitarëve përmendim: iriqi, urithi, lakuriq nate, lepur i murrëm, miu, gjumashi, qelbësi, etj. Ndër gjitarët grabitqar përmendim dhelprën, shqarthin dhe nuselalën

#### 1.4.6 Cilësia e ajrit

Gjate zbatimit të raportit në fjale nuk ka qene e mundur mbledhja e të dhënave në lidhje me cilësinë e ajrit në zonën ku do të zhvillohet projekti, dhe në zonat përreth. Megjithatë, ky aspekt do të marrë rendesi vetëm gjatë fazës së ndërtimit.

Në bazë të të dhënave të monitorimit, ajri urban në këto zone rezulton i pastër për 4 treguesit e monitoruar, SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub>, dhe Pb të cilët rezultojnë brenda normave të lejuara të Standardit Shqiptar dhe të BE në të gjitha stacionet dhe qytetet e monitoruara.

Në përgjithësi erërat mbizotëruese vijnë nga anët veriperëndimore dhe juglindore të objektit. Ky fillad freskues detar mund të vërehet veçanërisht gjatë periudhës së verës. Për të vlerësuar situatën në lidhje me cilësinë e ajrit u përdorën të dhëna mbi ndotësit e ajrit të marra nga stacionet matëse ekzistuese më përfaqësuese dhe më pranë zonës së projektit.

Cilësia e tanishme e ajrit në zonën e Projektit është tepër e varfër: në pjesën perëndimore të dhënat e matura japin një vlerë mesatare vjetore të matur të PM<sub>10</sub> (grimca me masë 10 micrometer ose më pak) prej 354 µg/m<sup>3</sup>. Në pjesën lindore PM<sub>10</sub> është 96 µg/m<sup>3</sup>. Këto vlera duhen krahasuar me standardin shqiptar për këtë parametër që është 70 µg/m<sup>3</sup> dhe standardin Evropian që është 40 µg/m<sup>3</sup> (që duhet pakësuar në 20 në të ardhmen).

Ndotësit e ajrit mund të jenë grimca pluhuri, kimikate apo materiale biologjike, të cilat kanë efekte mbi organizmin e njeriut, mjedisin apo atmosferën.

Disa nga grupet më të rëndësishme të indikatorëve të cilësisë së ajrit janë:

*SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe NH<sub>3</sub> (amonjaku), të cilët shkaktojnë edhe shirat acide;*

*CO<sub>2</sub>, CH<sub>4</sub> (metani), NO<sub>2</sub>, të cilët lidhen me emëtimin e gazrave;*

*PM<sub>10</sub>, LNP, që tregojnë masën e grimcave të ngurta në ajër.*

#### 1.4.7 Zhurmat

Zhurma nga aktivitetet e ndërtimit mund të jetë e rëndësishme për një periudhë të kufizuar kohe. Nivelet e zhurmes të shkaktuara nga aktivitetet e ndërtimit mund të ndryshojnë shumë, në varësi të fazës së ndërtimit dhe detyrës specifike që po kryhet.

Të gjitha pajisjet që leshojnë zhurmë do të mirembahen ashtu siç duhet për të minimizuar ndikimin e zhurmes në zonë. Pajisjet që leshojnë zhurmë duhet të plotësojnë standartet e BE rreth zhurmes të shkaktuar në mjedis.

Projekti në këto zone që kerkohet të zhvillohet përfshin dhe karakterizimin e dheut, ujit nentokësor dhe sedimenteve detare të zonës në fjale me qëllim mbledhjen e informacionit të qartë mbi ndikimet teknike dhe ekonomike të ndotjes, e cila potencialisht ekzistonte që më parë, duke marrë parasysh legjislacionin respektiv ndërkombëtar.

Sipas vendndodhjes se zones , ne pjesen e brendshme te parkut kombetar dhe ne nje distance te larget prej shtepive te banimit emetimi i zhurmave parashikohet te jete nje fenomen qe nuk duhet marre shume ne konsiderate.

Gjate periudhës së ndertimit, Kontraktorit i perket e drejta per te gjetur dhe vleresuar zgjidhje te tjera te mundshme per mënjanimin e ndotjes ekzistuese dhe per kete duhen gjetur forma stimuluese.

Duke iu referuar ligjit Nr.7994 , dt.12.07.2007 , *”Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis “* investitori ka marre te gjitha masat per zhurma sa me vogla ne kete aktivitet qe kerkon te zhvilloje nepermjet :

- a) përzgjedhjes dhe përdorimit të pajisjeve që lëshojnë zhurmë të niveleve të ulëta,
- b) përzgjedhjen e vendit, që instalimi dhe funksionimi i mjeteve e pajisjeve që lëshojnë zhurmë, të garantojnë nivelin kufi në të gjitha mjediset, të cilat ndikohen prej saj ,
- c) masat parandaluese e zbutëse të zhurmës në pikën e lëshimit , përgjatë rrugëve të përhapjes dhe në mjediset që ndikohen prej saj.

Si një hapësirë me sfond kryesisht rural ndotjet akustike janë minimale duke karakterizuar ketu vetem zhurmen e mjeteve levizese tokesore apo afer ndonje lokali te cilet jan ete pakte

krahasimisht me siperfaqen e parkut .

#### 1.4.8 Popullsia

Bashkia e re Divjakë kufizohet në veri me bashkinë Rrogozhinë, në lindje me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik. Kryeqendra e bashkisë së re do të jetë qyteti i Divjakës, i shpallur qytet me vendim qeverie në vitin 1996.

##### **Bashkia Divjakë**

| Qarku | Qendra e Bashkisë | Njësitë administrative përbërëse | Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre                                                                                   | Popullsia sipas Census 2011 | Popullsia sipas Regjistrat Civil | Sipërfaqja KM <sup>2</sup> |
|-------|-------------------|----------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|----------------------------------|----------------------------|
| Fier  | Qyteti Divjakë    | Divjakë                          | Qyteti Divjakë Fshatrat; Mizë, Xengë, Germenj i Madh, Germenj i Vogël, Hallvaxhias, Bregas, Dushk Cam, Zharnec, Bishtçukas | 34,254                      | 53,372                           | 309.58                     |
|       |                   | Tërbuf                           | Fshatrat; Çermë Shkumbin, Çermë Proshkë, Sulzotaj, Çermë e Sipërme, Tërbuf, Shënepremte, Çermë Pasha                       |                             |                                  |                            |
|       |                   | Grabjan                          | Fshatrat; Grabjan, Stravec, Ferras                                                                                         |                             |                                  |                            |
|       |                   | Gradishtë                        | Fshatrat; Këmishtaj, Mertish, Gorica, Sopës, Fier Seman, Gradishtë, Gungas, Spolet, Babunjë                                |                             |                                  |                            |
|       |                   | Remas                            | Fshatrat; Remas, Muçias, Karavasta Fshat, Gure, Kryekuq, Kamenicë, Karavasta e re, Adriatik                                |                             |                                  |                            |

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e Divjakës numëron një popullsi prej 34.254 banorësh ndërkohë që në regjistrin civil rezulton një popullsi 53.372 vetë. Territori i bashkisë së re është 309.58 kilometra katrore. Në bazë të censusit, densiteti i popullsisë është 110 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrat civil densiteti është 172.40 banorë/km<sup>2</sup>.

Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradisht dhe Remas. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Lushnjes dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 36 fshatra. Për të parë listën e plotë të qyteteve dhe fshatrave të kësaj bashkie :

Bashkia e Divjakës është nga të paktat bashki të krijuara nga reforma administrative dhe territoriale e cila përbëhet pothuajse tërësisht nga zona rurale. Bashkia e re ka një shtrirje veri-jug



ndërkohë që rrugët janë më së shumti në drejtimin lindje-perëndim dhe lidhja rrugore mes qytetit të Divjakës dhe komunave Gradishtë e Rremas është e dobët.

Bashkia e re ndodhet në një zonë tërësisht rurale dhe pjellore, ndërkohë që pjesë e territorit të kësaj bashkie është edhe parku kombëtar Divjakë-Karavasta, si dhe plazhi i Divjakës.

Bashkia e re ka aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe në një masë më të vogël peshki min në lagunën e Karavastasë. Prodhimi kryesor bujqësor janë bostanoret, të cilat shiten në tregun e brendshëm si dhe eksportohen në shumë vende të Europës qendrore dhe lindore.

Divjaka ka perspektivë të mirë për zhvillimin e turizmit detar si dhe ekoturizmit. Gjatë viteve të fundit këtu është shfaqur turizmi i vrojtimit të zogjve për shkak të pranisë së një kolonie të vogël pelikanësh në zhdukje në lagunën e Karavastasë.

Turizmi është zhvilluar më së shumti për turistët ditorë dhe kulinaria është e përqendruar te prodhimet e peshkut, për të cilat zona është e famshme në të gjithë vendin. Gjithashtu, Divjaka ka një jetë artistike dhe kulturore që shumë qytete do ia kishin zili. Këtu funksionon më së miri grupi artistik i qytetit, me djem dhe vajza valltarë, të cilët përfaqësojnë Divjakën në aktivitete të ndryshme kulturore. Po ashtu edhe sporti është në nivele mjaft të mira, ku duhet të përmendim që ekipi i volejbollit për femra është mjaft mirë i përfaqësuar në aktivitete brenda dhe jashtë vendit.

## 2 (a) Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes. Ku propozohet të zbatohet projekti shoqëruar me fotografi

Mbulesa bimore e hapësirës bregdetare te Divjakes dhe parkut ne teresi është relativisht e varfër në territoret fushore dhe e pasur në ato kodrinore. Mungesa e bimësisë në zonat fushore, shpjegohet me zhdukjen e bimësisë higrofitë nga veprimtaria ekonomike për sigurimin e tokave bujqësore. Por krahas shyllëzimeve, gjatë periudhës komuniste janë bërë pyllëzime duke krijuar blloqe dhe masive pyjore, siç janë brezi i pishave të buta përgjatë bregdetit dhe sipërfaqet e pyllëzuara me pisha mesdhetare në kodrat ne afersi .

Nga pikpamja floristike kjo hapësirë bregdetare bën pjesë në zonën e shkurreve dhe dushqeve mesdhetare e cila shtrihet nga niveli i detit dhe deri në lartësinë më të madhe të saj. Këtu vegjetojnë shumë lloje të vendit tonë që përveç vlerave prodhuese kanë dhe vlera mbrojtëse, rekreative e turistike. Hapësira ka florë me një gamë të gjerë llojesh, madje shumë lloje kanë edhe vlera të rëndësishme mjekësore, industriale, ushqimore dhe dekorative, duke mbartur kështu edhe vlera ekonomike. Bimësia natyrore, arealet më të përhapura siç e theksuam më sipër i ka në territoret kodrinore dhe në brigjet e lumenjve. Mbulesa bimore përbëhet nga shkurre mesdhetare të përfaqësuar nga makja dhe shiblaku, pyjet e dushkut dhe pyjet e pishave të futura artificialisht.

*Shkurret mesdhetare* – areali me makje shtrihet në formën e një brezi të plotë në të gjithë anën perëndimore e jugore të parkut . Lloje të makjes përmendim xina, marja, mërsina, ilqja, shqopa etj. *Mareja* (Arbutus unedo) është shoqëruar dhe me bimësi tjetër. *Shqopa* (Erica arborea) gjendet ne kete zone si bime e rendeishme dhe rrënjët e kësaj bime janë shumë të kërkuar në tregun vendas dhe të huaj. *Gjëneshtra* (Spartium junceum) gjendet kudo në territoret kodrinore, përdorej nga banorët vendas për punimin e shportave dhe koshave për nevojat e tyre në bujqësi. Këto punime artizanale me gjëneshtra vitet e fundit po kërkojnë nga të huajt që vlerësojnë punën e dorës.



*Dëllinja* ( *Juniperus oxycedrus*) me përhapje të zakonshme, frutat e saj janë me vlera ekonomike pasi kanë efekte shëruese për sëmundje të ndryshme dhe mund të përdoren dhe për prodhimin e rakisë. *Dafina e egër* (*Laurus nobilis*) gjendet në kodrat më të larta të kesaj zone dhe ka vlera mjekësore.

Shkurret gjetherënëse përfaqësohen nga bungbuta në trajtë shkurreje, shkoza e zëzë të shoqëruara nga frashëri i bardhë në disa areale gjendet dhe shega e egër.



Fig. 2 Pamje nga mbulesa bimore ekzistuese në zonën ku do të ndërtohet

### 3 (b) Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij

Në afërsi të zonës ku do të ndërtohet nuk ka burime ujore. Por rajoni në të cilin zhvillohet ky projekt ka këto veçori:

Ky rajon i mbrojtur nën administrimin e Bashkisë Divjake e cila konsiderohet si një nga zonat me vlera të veçanta natyrore dhe të biodiversitetit. Zonat kryesore të parkut Kombëtar Divjake-Karavasta përbëhen nga Laguna e Karavastasë, shtretërit e lumenjve të vjetër Seman dhe Shkumbin, emisarët e Terbufit dhe Myzeqesë, rezervuarët bujqësore, tokat bujqësore, pyjet përgjatë anëve të lumenjve Seman dhe Shkumbin, pylli Mesdhetar me pisha, pyjet dhe zonat e pyllëzuara në kodrat e Divjakës, pemët frutore, ullishtat, vreshtat dhe agrumet.

Pellgu ujembledhës i lumit të Semanit dhe Shkumbinit mbledh ujrat e reshjeve, që këtu marrin vlera nga 1000 mm deri 1500 mm në vit.

Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta (PKDK) është kompleksi ligatinor më i madh jo-bregdetar në Shqipëri, i përbërë nga katër lagunat (Karavasta, Godullat, Godullat e Pishës, Spiaxho) me një sipërfaqe prej afro 5.000 hektarësh, duke përfshirë dunat e rërës dhe deltën e lumit që ndodhet në pjesën qendrore të Rajonit Perëndimor, ndërmjet lumit Shkumbin në veri dhe lumit Seman (Kanali i Myzeqesë) në jug, 40 km në perëndim të qytetit të Lushnjës nga ana e bregdetit Adriatik. Laguna e Karavastasë është sipërfaqja më e madhe (4.100 ha) e këtij kompleksi ligatinor; ajo është 15.4 km e gjatë dhe 4.1 km e gjerë. Thellësia maksimale është 1,3 m dhe ka një thellësi mesatare prej 0.7 m. Në pjesën lindore kompleksi është i rrethuar nga Kodrat e Divjakës, 18 km të gjata dhe 5 km të gjera. Pika më e lartë është Guri i Gomares me 192 m mbi nivelin e detit, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujembledhës është rreth 6.500 ha. Laguna është e ndarë nga deti prej pyllit me pisha të Divjakës dhe në pjesën lindore tokat bujqësore kufizohen me lagunën. Laguna është e ndarë nga deti me pyllin e pishës së Divjakës dhe lagunën e Godullës.





#### 4 (c) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër

Aktivitetet që do të japin ndikime të mundshme negativisht në mjedisi gjatë të gjitha fazave tëzbatimit tëprojektit, asaj parapregatitore, të ndertimit të objektit janëveprimtaritë si:

- Gërmimet e tokës dhe dhe pastrimi e sistemi i sheshit ku do të ndertohet objekti;
- Percaktimi i trajtimi i rrugëve për qarkullim të automjeteve në objekti e lidhja me ato jashtë
- Rrethimi i sheshit të ndertimit.
- Hapja e themeleve, punime germimi;
- Ndërtimi i themeleve dhe krejt objektit; Keto veprimtari mund të ndikojë në mjedisin biofizik dhe social –ekonomik nga:
- Zenia e përkohëshme ose e tëpërherëshme e tokës;
- Përdorimi i makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit;
- Përdorimi i materialeve të ndërtimit;
- Përdorimii karburantit gjatë ndërtimit;
- Gjenerimi i emisioneve në ajër;
- Gjenerimi i zhurmave nga automjetet per ndertimin si dhe i makinerive e pajisjeve që përdoren per ndertimin e objektit;
- Trajtimi dhe depozitimi i mbetjeve të prodhuara.

##### 4.1 Ndikimet në tokë

Gjatë ndërtimit të objektit do të kemi mbetje të ngurta të cilat do të ndikojnë në mjediset tokësore

Materialet e germuara qe jane te menduara per rishfrytezim do te menaxhohen dhe transportohen deri ne minimum dhe do te depozitohen ne nje menyre qe te minimizohet efekti i motit. Koha ndermjet germimit dhe rishfrytezimit gjate periudhave te thata do te mbahet ne nje minimum. Gjate periudhave te zgjatura te thatesires kontraktori do te ndaloje germimet dhe do vendose keto materiale per te parandaluar degradimin per shkak te thatesires.

Makinëritë e ndertimit si dhe makinëritë e renda që bejnërregullimin e tokës mund të ndotin zonën me derdhjet e naftës, dhe mund ngjeshin ose të dëmtojë tokën në zonën rreth objektit. Ndikimet e mundshme:

- Humbja e tokës së lirë nga ndertimi i objektit;
- Ngjeshja e tokës nga mjetet qarkulluese në zonën rreth objektit gjatë punimeve të ndertimit; • Ndotja e tokës, e cila mund të ndodhë me derdhjet e naftës nga transporti dhe mjeteve të punës ose përmes ujërave të zeza dhe mbetjet urbane nga sektori i punimeve gjatë aktiviteteve të ndërtimit. Pasi janë zbatuar masat e duhura zbutëse, ndikimi i përgjithshëm mbi cilësinë e tokës mund të vlerësohen të një rëndësie të vogël dhe me masë të kufizuar

| Lloji i ndikimit në tokë                  | Identifikimi i ndikimit |    |                    |    |
|-------------------------------------------|-------------------------|----|--------------------|----|
|                                           | Gjatë ndërtimit         |    | Gjatë shfrytëzimit |    |
|                                           | Po                      | Jo | Po                 | Jo |
| Ndryshime topografike të terrenit         |                         |    |                    |    |
| Prishja e tokës bujqësore                 |                         |    |                    |    |
| Ndotja e tokës nga rrjedhjet              |                         |    |                    |    |
| Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta       |                         |    |                    |    |
| Ndotja e tokës nga depozitimet e llumrave |                         |    |                    |    |

| Lloji i ndikimeve në përfitimin e tokës                                    | Identifikimi i ndikimit |    |                    |    |
|----------------------------------------------------------------------------|-------------------------|----|--------------------|----|
|                                                                            | Gjatë ndërtimit         |    | Gjatë shfrytëzimit |    |
|                                                                            | Po                      | Jo | Po                 | Jo |
| Shkatërrim banesash                                                        |                         |    |                    |    |
| Ndryshime të rëndësishme në programet për të ardhmen e përdorimit të tokës |                         |    |                    |    |
| Rivendosje banesash                                                        |                         |    |                    |    |
| Shpronësime të tokës                                                       |                         |    |                    |    |

## 4.2 Ndikimet ne Ujrat Nentokesore

Nuk ka prezence te ujrave nentokesore. Vetem sistemi i kanalizimeve, i cili do te jete i mireorganizuar dhe do te shkarkoje ne kolektorin kryesor.

Kjo zonë, e cila është e përbërë nga shtresëzime që nuk ndikojnë në ndonjë aqufer të rëndësishëm i cili të influencohet negativisht nga shkarkimet e mundëshme por behet pjesë e një mjedisi urban të konsoliduar. Megjithatë shtresëzimet ujëmbajtëse mund të ndotet nga derdhjet e naftës dhe të ujërave të përdorura të krijuara gjatë punimeve të ndërtimit të ndertimit. Ndikimet e mundshme mbi ujërave nëntokësore:

- Ndikimet e mundshme mbi ujërave nëntokësore nga punimet e ndërtimit, themelet dhe vepra të tjera të lidhura me tokën;
- Makineritë që punojnë nëndërtim dhe kamionet transportues, të cilat mund të sjellin rrezikun e ndotjes nga karburanti dhe vaji.

Gjate ndertimit mund the ndodhin impaktet e meposhtme te mundshme:

- *ne ujerat nentokesore si rezultat I cpimeve dhe germimeve per themelet apo derdhjet aksidentale te karburanteve dhe vajrave gjate ndertimit nga automjetet e ndertimit dhe makinerite qe perdoren pa kriter gjate menaxhimit te veprimtarive te ndertimit;*

### 4.3 Ujrat Siperfaqesore

Ujrat siperfaqesore, përfaqësohen vetëm nga kullimet edhe drenazhet që do të sistemohen nëpërmjet kunetave edhe pusetave shimbledhëse që do të shkarkojnë në kolektorin kryesor

Nje impakt i vogël negativ mund të ndodhe në rrjetet e vogla drenazhuese.

- *Në ujrat siperfaqesore si rezultat i ndërprerjeve të vazhdueshme të përkohshme nga kanalet e drenazhimit apo ndotja pa kriter gjatë menaxhimit të veprimtarive të ndërtimit;*

| Lloji i ndikimeve në ujë                                                             | Identifikimi i ndikimit |                                                                                      |                                                                                     |                                                                                      |
|--------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                                      | Gjatë ndërtimit         |                                                                                      | Gjatë shfrytëzimit                                                                  |                                                                                      |
|                                                                                      | Po                      | Jo                                                                                   | Po                                                                                  | Jo                                                                                   |
| Trajtimi i ujërave të ndotur                                                         |                         |   |  |                                                                                      |
| Ndotja e ujit prej pluhurit, acideve, derdhjeve aksidentale dhe substancave të tjera |                         |   |                                                                                     |   |
| Ndikimi sekondar në ndotjen e ujit për toka bujqësore, ujërat nëntokësor etj.        |                         |   |  |                                                                                      |
| Modifikim në drenazhimin e ujërave natyrorë                                          |                         |   |                                                                                     |   |
| Ndotja e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor nga llumrat                             |                         |  |                                                                                     |  |

### 4.4 Ndikimet në florë, faunë ( Biodiversitet)

Ndikimet e mundshme mbi burimet ekologjike dhe biodiversitetin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë tjetërsimin e vendit si habitat i modifikuar nga njeriu e jo natyror, shqetësime të kafshëve (kryesisht shpendëve) të mjedisit urban ose megrim I përkohshëm i atyre të zonës më larg sheshit të ndërtimit shkaktuar nga zhurma, dhe prania e njerëzve dhe mekanizmave, ndotjet nga pluhuri dhe emetimi i substancave të ndotura, rreziku i zjarrit në afërsi të shesheve të ndërtimit, çojnë në degradimin e kushteve të nevojshme që mbështesin biodiversitetin.

Duke qënë se vendi ku do të ndërtohet objekti është mjedis urban me dendësi deri të lartë të objekteve ndërtimore, në përgjithësi karakterizohet me vlera të uleta përsa i përket biodiversitetit. Në kushtet e habitateve artificiale dhe mungesë të specieve endemike, të rralla ose të rrezikuara ndikimi është i ulët.

| Lloji i ndikimit në florën dhe faunën                         | Identifikimi i ndikimit |    |                    |    |
|---------------------------------------------------------------|-------------------------|----|--------------------|----|
|                                                               | Gjatë ndërtimit         |    | Gjatë shfrytëzimit |    |
|                                                               | Po                      | Jo | Po                 | Jo |
| Shkatërrimi i rëndësishëm i habitateve natyrore               |                         |    |                    |    |
| Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit                        |                         |    |                    |    |
| Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë përmes zonës së virgjër |                         |    |                    |    |
| Përçarje apo izolim të habitateve të egra                     |                         |    |                    |    |

#### 4.5 Ndikimet në infrastrukturë

| Lloji i ndikimeve në interesin publik<br>(Infrastrukturë)                                                        | Identifikimi i ndikimit |    |                    |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|----|--------------------|----|
|                                                                                                                  | Gjatë ndërtimit         |    | Gjatë shfrytëzimit |    |
|                                                                                                                  | Po                      | Jo | Po                 | Jo |
| Ndryshimi i destinacionit të aktivitetit do të ketë ose jo nevojë për ndryshim në këtë fushë të interesit publik |                         |    |                    |    |
| Energji elektrike                                                                                                |                         |    |                    |    |
| Sistemi i komunikacionit                                                                                         |                         |    |                    |    |
| Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza                                                                        |                         |    |                    |    |
| Sistemi i ujësjellësit                                                                                           |                         |    |                    |    |
